



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**DOKUMENTAT E PROCEDURËS KONKURRUESE “DHËNIA
ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR
PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN
DHE TRANSFERIMIN E NJË PORTI TURISTIK NË QYTETIN
E VLORËS (MARINA VLORË)”**

NJOFTIMI I KONTRATËS

I. Autoriteti Kontraktor

Seksioni 1

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor;

Emri

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Adresa

Rruga “Abdi Toptani”, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri

Adresa e Internetit

www.infrastruktura.gov.al

I.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion qëndror

Institucion i pavarur

Njësitë e Qeverisjes Vendore

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Lloji i Kontratës

Punë

2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Objekti i kontratës: “Dhënia me koncesion/partneritet publik privat për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një porti turistik në qytetin e Vlorës (Marina Vlorë)”.
2. Forma e kontratës: B.O.T (Ndërtim – Operim – Transferim)
3. Burimi i financimit: Investim privat

2.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja 35 vjet

2.4 Vendndodhja e objektit të kontratës:

Marina Vlorë parashikohet të ndërtohet në qytetin e Vlorës dhe konkretisht në portin aktual të këtij qyteti.

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës nr. 9.

3.2 Sigurimi i ofertës

Operatori Ekonomik në një procedurë koncesioni/partneritetit publik privat, paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, sipas Shtojcës 3.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është në vlerën 2% të vlerës së projektit të propozuar (pa TVSH) nga Ofertuesi.

Seksioni 4 Procedura

IV.1 Lloji i procedurës:

E hapur	E kufizuar	Me negociim me shpallje paraprake
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Lidhur me rëndësinë:

Kriteri 1 “Teknik”	35 pikë
Nën kriteri a) “Projekti dhe zgjidhja teknike”	10 pikë
Nën kriteri b) “Superstruktura”	10 pikë
Nën kriteri c) “Infrastruktura”	10 pikë
Nën kriteri d) “Logjistika e operimit të sigurisë së mjeteve”	5 pikë
Kriteri 2 “Plani i Mirëmbajtjes”	15 pikë
Kriteri 3 “Fee koncesionare”	15 pikë
Kriteri 4 “Eksperienca në Projektim”	15 pikë
Kriteri 5 “Ndikimi Social dhe Mjedisor”	10 pikë
Kriteri 6 “Koha e ndërtimit ”	10 pikë
Totali	100 pikë

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 26/02/2021

Ora: 14:00

Vendi: Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 26/02/2021

Ora: 14:00

Vendi: Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike

Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 ditë

4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	<input checked="" type="checkbox"/>
Anglisht	<input checked="" type="checkbox"/>
Tjetër	<input type="checkbox"/>

Shenim: Dokumentat të lëshuara/përgatitura në gjuhën shqipe nuk duhen shqyrtuar në gjuhën angleze ndërsa dokumentat e lëshuara/përgatitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumente me pagesë:

Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
----	--------------------------	----	-------------------------------------

5.2 Vlera e tarifës që duhet të paguhet nga operatori ekonomik në rast të një ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik është 10% e vlerës së sigurimit të ofertës.

5.3. Vlera e tarifës së ATRAKO, referuar nenit 12 të Ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" të ndryshuar, është Shuma që do të paguhet për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) nga ofertuesi fitues para nënshkrimit të Kontrates.

5.4. Shuma e kompensimit, referuar nenit 25 të Ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe Partneritetin publik Privat" të ndryshuar, dhe nenit 15 të VKM nr. 575 datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar, është shuma që do të paguhet nga ofertuesi fitues, propozuesit për përgatitjen e studimit të fizibilitetit vetëm nëse propozuesi ka marrë pjesë në gare por nuk është shpallur fitues. Shuma e kompensimit për shpenzimet kryera nga propozuesi për përgatitjen e studimit të fizibilitetit do të jete sipas faturave që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve, vlerë e cila nuk mund të jete më e lartë se 1% e vlerës së investimit.

5.3 Informacione shitesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumenteve të procedurës konkurruese)

Agjencia e Prokurimit Publik: www.app.gov.al

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **6/01/2021**

II. UDHËZIME PËR OFERTUESIT

1. HYRJE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur të implementojë projektin për dhënien me koncesion/partneritet publik privat të portit turistik “Marina Vlorë”.

Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues do të bëhet në bazë të një procedure konkurruese (procedurë e hapur) sipas kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese të specifikuara në këtë dokument.

Kohëzgjatja e kontratës koncesionare/PPP do të jetë 35 (tridhjetë e pesë) vjet nga hyrja në fuqi e saj.

1.1. Informacion i mëtejshëm:

Përshkrim i përgjithshëm

a. Pozicioni gjeografik

Vendndodhja e parashikuar e objektit është në qender te qytetit të Vlorës dhe konkretisht në portin aktual të këtij qyteti i cili eshte nen administrimin e Ministrisë se Infrastrukturës dhe Energjisë. Qyteti i Vlorës ndodhet në bregdetin jugor të Shqipërisë, afërsisht 150 km në veri të kufirit tokësor me shtetin e Greqisë dhe konkretisht 157 km larg nga pika kufitare më e madhe me Greqinë që është Kakavia rreth 140 km (75 Nm) në vijë detare, me Portin e Korfuzit dhe vetëm 90 km (50 Nm) nga rajoni i Puglias në Itali. Kufiri tokësor me Malin e Zi është afërsisht 234 km në veri të Vlorës, dhe hyrja në Gjirin e Kotorrit (gjithashtu formon kufirin tokësor midis Malit të Zi dhe Kroacisë) është rreth 130 Nm nga Vlora në vijë detare. Qyteti i Vlorës është afërsisht 250 km larg nga pika doganore e Morinës si edhe vetëm 170 km larg nga pika doganore me Republikën e Maqedonisë së Veriut.



c. Lidhja me infrastrukturen inxhinierike

Porti konsiderohet të bëhet pjesë e Master Planit të Lungomares në Vlorë e cila do ti marrë një pjesë të konsiderueshme nga sipërfaqja e portit, ndërsa Rruga e Re Trans-Ballkanike ose sic quhet ndryshe “Korridori Kulturor”, pjesa e parë e së cilës ka përfunduar, do të shtohet me një segment të dytë që fillon nga rruga ekzistuese për në port. Gjithashtu se fundi nga Qeveria Shqiptare, është promovuar edhe projekti i Parkut Publik i shtrire ne hapësirën këmbësore nga rrethrotullimi i Skelës deri tek porti, ku do të lidhë bulevardin e ri Ismail Qemali me Lungomaren. Konstatohet se nje pjese e konsiderueshme e ketij parku shtrihet brenda territorit te Portit te Vlores.

Gjurma e objektit të koncesionit “ Marina Vlorë” është is më poshtë:

PLAN RILEVIMI

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8604
 NR/LI PASURISE _____ VOL. _____
 INDEKSI I HARTES VL-O-11
 SHKALLA 1:2500
 ADRESA E PASURISE: Rr/nr _____ VLORE
 O/F _____ Rr/L _____
 P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____
 PRONARI _____



POINTS	EASTING	NORTHING
01	4371362.891	4481081.776
02	4371411.889	4481058.438
03	4371369.916	4480968.617
04	4371345.668	4480972.004
05	4371654.417	4480794.516
06	4371615.794	4480713.980
07	4371616.732	4480713.394
08	4371574.798	4480622.297
09	4371577.018	4480621.264
10	4371542.199	4480547.352
11	4371527.889	4480553.724
12	4371562.318	4480627.598
13	4371563.948	4480626.784
14	4371606.077	4480718.153
15	4371607.386	4480718.209
16	4371642.154	4480794.110
17	4371344.929	4480869.050
18	4371317.397	4480757.085
19	4371276.823	4480767.187
20	4371247.386	4480634.370
21	4371229.136	4480629.017
22	4371227.866	4480638.082
23	4371229.957	4480639.001
24	4371229.533	4480647.031
25	4371220.279	4480650.973
26	4371283.736	4480900.479
27	4371335.146	4480887.590
28	4371358.206	4480879.568
29	4371369.734	4481004.208
30	4371347.895	4481015.008
31	4371350.731	4481050.494
32	4371302.211	4480879.591
33	4371331.345	4480872.430
34	4371306.695	4480774.122
35	4371277.595	4480781.418

RILEVIMI SIPAS FAKTIT

Plani i zbatimit duhet të përmbush standartet e pranuar ne Bashkimin European.

- 1.2.**Projekt koncesionar/PPP “Për Ndërtimin, Operimin dhe Transferimin e një Porti Turistik në Qytetin e Vlorës” është propozimi i pakerkuar i miratuar nga Autoriteti Kontraktues. Referuar nenit 25 te Ligjit nr.125/2013 “Per koncesionet dhe Partneritetin publik Privat” te ndryshuar, dhe nenit 15 te VKM nr. 575 datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar,, Shuma e kompensimit eshte shuma që do t’i paguhet nga ofertuesi fitues, propozuesit për përgatitjen e studimit të fizibilitetit vetëm nëse propozuesi ka marre pjese ne gare por nuk eshte shpallur fitues. Shuma e kompensimit per shpenzimet e kryera nga propozuesi per përgatitjen e studimit te fizibilitetit do te jete sipas faturave qe vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve, vlere e cila nuk mund te jete me e larte se 1% e vlerës se investimit.
- 1.3.**Këto udhezime ("Udhezimet për Ofertuesit") si dhe “Ftesa për Ofertë” i adresohet të gjithë subjekteve juridike ose bashkimeve të tyre, që kanë për qëllim të marrin pjesë në këtë procedurë konkurruese përzgjedhjeje.
- 1.4.**Shpenzimet: Ofertuesi fitues duhet të përballojë shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij si dhe çdo shpenzim tjetër do të kompesohet ashtu siç parashikohet në këto dokumente dhe në përputhje me Nenin 25 dhe nenit 29 të Ligjit Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.
- 1.5.**Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të ndërprerë përfundimisht këtë Procedurë konkurruese përzgjedhëse. Ofertuesi nuk ka asnjë të drejtë për të kërkuar ndonjë kompensim për kostot ose humbjet.

2. DOKUMENTET E PROCEDURËS KONKURUESE

2.1 Përmbajtja

2.1.1 Lloji i projektit dhe kërkesat teknike, procedura e konkurimit, kushtet e kontratës dhe kërkesat ligjore dhe ekonomike financiare përcaktohen në dokumentat e procedurës konkurruese të cilat përmbajnë:

SHTOJCAT

Shtojca 1:Formulari i Ofertës

Shtojca 2:Formulari i Ftesës për Ofertë i Procedurës së Kufizuar ose Negocimi me Shpallje

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike nga operatori ekonomik

Shtojca 6 Deklarata për konfliktin e interesit

Shtojca 7 Formulari i vlerësimit për realizimin e punimeve

Shtojca 8: Deklarata e disponueshmerisë së makinerive

Shtojca 9 Formulari për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes

Shtojca 10 Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore

Shtojca 11: Kriteret e vlerësimit

Shtojca 12: Vetëdeklarim për ofertuesit e huaj

Shtojca 13: Projekt-zbatimi dhe specifikimet teknike

Shtojca 14: Preventivat

Shtojca 15: Formulari për Njoftimin Skualifikimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 17: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 18: Kushtet e Veçanta të Kontratës

Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 20: Njoftim i Nënshkrimit të Kontratës

Shtojca 21. Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor

Shtojca 22: Formulari i Prokurës

2.1.2 Çdo ofertues duhet të marrë në konsideratë udhëzimet, kriteret, kushtet, specifikimet, afatet dhe të gjithë informacionin në dokumentat e procedurës konkurruese. Në rast se ofertuesi:

- i) nuk plotëson të gjithë dokumentacionin dhe informacionin në dokumentat e procedurës konkurruese; ose
- ii) paraqet nje ofertë, e cila nuk është në përputhje me kushtet dhe kërkesat e dokumentave të procedurës konkurruese;

Autoriteti Kontraktues do të përcaktojë se oferta nuk është në përputhje me kërkesat e dokumentave të procedurës konkurruese dhe do të refuzojë ofertën.

2.2 Sqarime mbi Dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese:

2.2.1 Ofertuesi, i cili kërkon sqarime apo ndryshime të dokumentave të procedurës konkurruese, duhet të paraqesë kërkesën e tij nëpërmjet personit të kontaktit për këtë

procedure konkurruese si është paraqitur në pikën I.2 (të njoftimit të kontratës) dhe sistemit të prokurimit elektronik .

Të gjitha përgjigjet së bashku me sqarimet përkatëse, duhet t'u bëhen të njohura të gjithë të interesuarve.

2.3 Ndryshimet në dokumentet e procedurës konkurruese:

- 2.3.1.** Në çdo kohë para afatit të dorëzimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues në çdo rast që bën ndryshime në dokumentat e procedurës duhet të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave sipas ligjit. AK mund për çdo arsye, me nismën e tij ose në përgjigje të kërkesave për ndryshime nga një ofertues, të ndryshojë dokumentat e procedurës ofertuese.
- 2.3.2.** Të gjitha ndryshimet e kryera nga Autoriteti Kontraktues do të publikohen në faqen e internetit të APP. Dokumentet e ndryshuara do të konsiderohen si dokumentet e procedurës konkurruese për këtë procedurë përzgjedhëse konkurruese.
- 2.3.3.** Në mënyrë që ofertuesit të kenë kohë të mjaftueshme për të bërë ndryshimet përkatëse në ofertën e tyre, Autoriteti Kontraktues mund, që me nismën e tij të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues sipas Ligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” do të publikojë afatin e ri për dorëzimin e ofertave në faqen e internetit të APP.

3. OFERTA: PËRGATITJA

3.1. Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:

- a) Formulari i Ofertës, plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojca 1 e DPK/PPP.
- b) Formulari i Sigurimit të ofertës, plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur këtyre dokumentave: Shtojca 3 e DPK/PPP.
- c) Dokumentat që lidhen me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat (*skica, projekte, etj*)
 - Studim Hidroteknik i objektit që do të ndërtohet,
 - Studim hidrologjik dhe hidrogjeologjik i objektit koncesionar,
 - Plani i zhvillimit dhe projektimit duhet të përmbajë:
 - Fazat e zhvillimit të investimit.
 - Grafikon e përfundimit të punimeve për çdo fazë, duke përcaktuar:
 - ❖ Afate konkrete për projektimin, fillimin e punimeve, përfundimin e ndërtimeve, fillimi i fazës së zbatimit.
 - ❖ Përlllogaritjen e klientëve potencial.
 - ❖ Një konceptim paraprak të planit të marketingut, duke treguar sesi klientët vendas dhe të huaj do të tërhiqen për të përdorur Portin Turistik “Marina Vlorë”.

Ofertuesi duhet të paraqesë një prezantim të përgjithshëm të projektit, duke përfshirë:

- Fazat e zhvillimit

- Metodologjinë për arritjen e objektivave të projektit
- Identifikimin e lidhjes me shërbimet dhe infrastrukturën afër kufijve të zonës së projektit.
- Operatori ekonomik (Investitori apo shoqëria e kontraktuar nga investitori) duhet të paraqesë studimin gjeologjik dhe batimetrinë e terrenit ku do të ndërtohet porti.
 - Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Studim mbi ndikimin në mjedis dhe impaktet përkatëse.

Ndërtimet detare dhe punimet civile

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë në mënyrë të detajuar përshkrimin e punimeve detare dhe civile.
 - Operatori ekonomik duhet të përshkruaj masat parandaluese kundrejt përmbytjeve, (stacionet e pompimit etj.)
 - Ofertuesi duhet të paraqesë në mënyrë të detajuar specifikimet e punëve të mëdha për:
 - ❖ Dallgëthyesin
 - ❖ Pontilet, korridoret sipas standardit, degëzimet (fingers), kanalet hyrese,
 - ❖ Kalatat, molet dhe sistemet mbrojtëse (fenders).
 - ❖ Vend akostimet, vend ankorimet, mënyren e ankorimit, llojet e spirancave.
 - ❖ Punimet e thellimeve/gërmimeve detare për të arritur thellesinë deri në – 4.5 metra
 - ❖ Ndërtesat dhe themelet kryesore
 - ❖ Rrugët dhe zonat e shtruara
 - ❖ Skemën e rrethimeve
 - ❖ Punimet Civile

Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja

- Ofertuesi duhet të paraqesë në mënyrë të detajuar përshkrimin e sistemit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, duke siguruar një menaxhim eficient dhe profesional të Portit Turistik “Marina Vlorë”..
- Ofertuesi duhet të paraqesë një përshkrim paraprak të bashkëpunimit të pritshëm të Portit Turistik “Marina Vlorë” me klientët e mundshëm.
- Ofertuesi duhet të respektojë Kodin Detar dhe Konventat ndërkombëtare në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Shërbimet e tjera dhe ndihmëse

Ofertuesi duhet të prezantojë në mënyrë të detajuar sistemin e aksesorëve të nevojshëm si më poshtë vijon:

- ❖ Sistemet e furnizimit me ujë të ëmbël,

- ❖ Sistemet e furnizimit me karburant me struktura mbrojtese dytesore,
- ❖ Sistemet e mbledhjes dhe kanalizimet e ujërave të zeza,
- ❖ Sistemin e tubacioneve për mbledhjen dhe riciklimin e ujërave të shiut nga sheshet dhe sipërfaqet e betonuara,
- ❖ Facilitetet e bregut për dorëzimin e mbeturinave vajore të anijeve (Sludge, slop),
- ❖ Skemat Elektrike,
- ❖ Skemën e infrastrukturës rrugore duke patur parasysh ekonomizimin e tyre në mënyrë që mos kufizojë sipërfaqet e shesheve.

Procesi i zbatimit të projektit:

Ofertuesi duhet të paraqesë një Plan Zbatimi, i cili duhet të përmbajë.

- a. Procesin e zbatimit të projektit.
- c. Skemën e zhvillimit të aktiviteteve.
- d. Grafikët dhe afatet.
- e. Monitorimi dhe kontrollin e cilësisë.

Impaktet sociale, mjedisore dhe meteo – detare.

Ofertuesi duhet të marrë përsipër shmangien ose zbutjen e impakteve sociale e mjedisore duke kryer një vlerësim të tyre dhe duke shpjeguar efektet që do të ketë Porti Turistik "Marina Vlore", duke paraqitur një studim nga një ekspert ose studio e licencuar në lidhje me impaktin mjedisor dhe social që do të ketë ndertimi dhe zhvillimi i këtij projekti.

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Çdo e dhënë e rreme do të përbëjë për Autoritetin Kontraktues shkakun ligjor për skualifikimin në çdo kohë të Ofertuesit. Nëse kjo zbulohet ose njoftohet pas lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i japë fund marrëdhënies të kontratës në mënyrë të njeanëshme dhe të marrë dëmshpërblim për humbjet aktuale. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhënia e informacioneve të rreme, përpilimi i dokumenteve të rreme apo të falsifikuara si dhe çdo deklaratë apo ndonjë e dhënë tjetër, që nuk pasqyron të vërtetën, konsiderohet vepër penale.

Ofertuesi duhet të përdorë vetëm Dokumentat e Procedurës Konkurruese, pa i bërë asnjë ndryshim përmbajtjes së tyre.

3.2 Sigurimi i Ofertës:

- 3.2.1** Si pjesë e ofertës së tij teknike ofertuesi duhet të paraqesë Sigurimin e Ofertës, sipas Formularit të Sigurimit të Ofertës (paraqitur në Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës), në vlerën 2% të vlerës së projektit të propozuar (pa TVSH) nga Ofertuesi.

3.2.2 Sigurimi i Ofertës është i detyrueshëm të paraqitet në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë aktivitet. Ofertuesi duhet të garantojë, që Sigurimi i Ofertës të jetë i vlefshëm për një periudhë 30 ditë pas përfundimit të vlefshmërisë së ofertës, e cila është 150 ditë. Pra oferta duhet të sigurohet për 180 ditë nga data e përfundimit të afatit të dorëzimit të saj. Për arsye të motivuara Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, në rast se rrethana të caktuara ndikojnë në shtyrjen e afatit të vlerësimit të ofertës përkatëse ose në dorëzimin e Sigurimit të Kontratës ose në çdo rast tjetër që ndikon në shtyrjen e ndonjë afati të detyrueshëm. Mos shtyrja e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës përbën shkak për skualifikimin e Ofertuesit.

3.2.3 Sigurimi i Ofertës duhet të dorëzohet bashkë me ofertën, para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Çdo ofertë e pashoqëruar me Sigurimin e Ofertës do të refuzohet nga komisioni i dhënies së konçesionit/PPP. Sigurimi i Ofertës duhet të paraqitet në emër të: i) shoqërisë, në rast se Ofertuesi është një shoqëri e vetme; ose ii) në emër të shoqërisë kryesuese në rast se Ofertuesi është një bashkim i përkohshëm i shoqërive.

3.2.4 Me kërkesë të Ofertuesit jofitues, Autoriteti Kontraktues do t'i kthejë atij Sigurimin e Ofertës sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës apo çdo zgjatje të afatit të saj.

3.2.5 Sigurimi i ofertës të Ofertuesit Fitues do të kthehet atij pas dorëzimit të Sigurimit të Kontratës pranë Autoritetit Kontraktues.

3.2.6 Sigurimi i ofertës mund të mbahet nga Autoriteti Kontraktues në rastet kur Ofertuesi:

- i) tërheq ofertën e tij gjatë procedurës konkurruese pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës;
- ii) nuk paraqet Sigurimin e Kontratës (në rast se shpallet fitues);
- iii) nuk nënshkruan kontratën konçesionare (në rast se shpallet fitues) brenda afateve kohore të specifikuar në Formularin e Njoftimit të Fituesit (Shtojca 16);
- iv) ka deklaruar të dhëna të rreme në ofertën e tij;
- v) në rast se shpallet fitues refuzon pagesën e shpenzimeve sipas pikes 1.3 me sipër.

3.3 Prokura: Çdo Ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Përkohshëm, kur Ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë një prokurë noteriale, në formën e përcaktuar në Shtojcën 21 që tregon se personi (personat) që kanë nënshkruar Ofertën kanë të drejtën e nënshkrimit të saj.

3.4 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës: Ofertat duhet të jenë të vlefshme për 150 ditë duke filluar nga momenti i përfundimit të “afatit kohor për dorëzimin e ofertave”. Një ofertë me një vlefshmëri më të shkurtër se afati i përcaktuar do të refuzohet nga komisioni i dhënies së konçesionit si e papranueshme.

Në mënyrë përjashtimore, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues dhe përgjigjja e Ofertuesit duhet të jenë në formë të shkruar. Në rast të zgjatjes së Afatit të

Vlefshmërisë së Ofertës, edhe afati i Sigurimit të ofertës do të zgjatet në përputhje me pikën 3.2.2.

3.5 Formati dhe nënshkrimi i Ofertës

3.5.1 Çdo ofertues duhet të përgatisë dhe dorëzojë (ngarkojë në sistem) ofertën në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Informacione të detajuara lidhur me ngarkimin e ofertës gjenden në manualin e përdorimit, i cili është publikuar në adresën <https://www.app.gov.al>.

3.5.2 Ofertuesi, i cili do të shpallet fitues i konkurrimit, do të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues ofertën origjinale. Oferta origjinale duhet të jetë e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi ose personat me të drejtë nënshkrimi (të autorizuar me prokurën e dorëzuar si pjesë të Ofertës Teknike , në përputhje me pikën 3.3) duhet të nënshkruajnë Ofertën duke:

- i) Nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe
- ii) Shënuar inicialet në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike.

3.5.3 Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP.

4. DOREZIMI I OFERTËS ORIGJINALE

4.1 Formati dhe nënshkrimi i ofertës

4.1.1. Në zbatim të VKM Nr. 130, datë 12.3.2014, “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat” dhe VKM Nr. 575 datë 10.7.2013, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve/partneritetit publik privat”, oferta do të dorëzohet në format elektronik në përputhje me udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik. Një informacion më të qartë të kësaj procedure do ta gjeni në faqen zyrtare www.app.gov.al.

4.1.2 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj çdo Ofertuesi ndaj çdo pretendimi apo ankese mbi paqartësi në mënyrën e dorëzimit të Ofertës me përjashtim të rastit kur një ofertë nuk sigurohet në mënyrën e duhur për shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur nga ana e Autoritetit Kontraktor.

4.1.3 Në çdo rast, Ofertuesit duhet të dorëzojnë në formë elektronike të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm si dhe të nevojshëm për prezantimin e ofertës së tyre.

4.1.4 Ofertuesi i shpallur fitues duhet të dorëzojë ofertën origjinale pranë Autoritetit Kontraktues. Oferta origjinale duhet të vendoset në një zarf/kuti, të jetë e mbyllur dhe e vulosur. Mbi zarf/kuti duhet të jetë pasqyruar emri dhe adresa e ofertuesit si dhe shënimi:

Ofertë për projektin “Për dhënien me koncesion/partneritet publik privat të portit turistik “Marina Vlorë”.

Oferta origjinale duhet të dorëzohet në adresën e mëposhtme:

Drejtuar:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Në vëmendje:	Komisioni i Dhënies së Koncesionit/PPP
Adresa:	Rruga “Abdi Toptani”, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri

4.2 Afati për dorëzimin e Ofertave

4.2.1 Ofertat duhet të dorëzohen në faqen e internetit të APP-së: www.app.gov.al.

brenda datës 26.2.2021, ora: 14.00

Ofertuesi i shpallur fitues do të njoftohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues për afatin e dorëzimit të ofertës origjinale.

5. HAPJA DHE VLERESIMI I OFERTAVE

5.1 Hapja e Ofertave

5.1.1 Komisioni i dhënies së koncesionit bën identifikimin e ofertuesve dhe hapjen e ofertave të dorëzuara në faqen e internetit të APP, pas mbarimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

5.2 **Vlerësimi i Ofertave**

5.2.1 Pas hapjes së ofertës Komisioni i dhënies së koncesionit/ppp do ta shqyrtojë atë për të përcaktuar nëse oferta është e pranueshme, nëse dokumentacioni i kërkuar është dorëzuar, nëse dokumentacioni i kërkuar për tu nënshkruar nga ofertuesi është nënshkruar rregullisht, dhe nëse Oferta është e rregullt.

5.2.2 Vlerësimi i Autoritetit Kontraktues do të bazohet në të dhënat dhe vetë përmbajtjen e Ofertës duke mos iu drejtuar burimeve të tjera. Megjithatë, nëse është e nevojshme, Komisioni i dhënies së koncesionit/ppp mund të kërkojë sqarime nga Ofertuesit, të cilat nuk përbëjnë një ndryshim të thelbit të Ofertës. Sqarimet duhet të jenë vetëm me shkrim ose/dhe të reflektuara në procesverbalin përkatës. Gjithashtu në raste të veçanta Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e tij për të përfshirë edhe ekspertë të ndryshëm, të cilët mund të ndihmojnë në trajtimin e atyre çështjeve, për të cilat Komisioni i dhënies së koncesionit/ppp has vështirësi.

5.2.3 **Oferta do të konsiderohet e pavlefshme nëse;**

- i) ofertuesi nuk ka dorëzuar Sigurimin e Ofertës;
- ii) oferta përmban të dhëna të rreme;
- iii) nuk ka plotësuar një ose të gjitha kërkesat sipas dokumentave të procedurës konkurruese.

5.2.4 Komisioni i dhënies së koncesionit/ppp vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentat e procedurës përzgjedhëse, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

5.2.5 Nëse më shumë se një ofertë financiare ka të njëjtën vlerë ose ka pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve.

5.2.6 Komisioni i dhënies së koncesionit/ppp harton klasifikimin përfundimtar, i cili duhet të njoftohet publikisht dhe t'i komunikohet Ofertuesve. Pas njoftimit të klasifikimit përfundimtar, çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është në kundërshtim me parashikimet e Ligjit Nr. 125/2013 "Per koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar dhe VKM nr. 575, datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve/partneritetit publik privat", i ndryshuar, duke përdorur formularin e Ankimit të Procedurës Konkurruese, të përcaktuar në Shtojcën 21.

5.2.7 Me mbarimin e procedurës ankimore komisioni i dhënies së koncesionit/ppp përgatit raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe i propozon Kryetarit të Autoritetit Kontraktues, rezultatet e arritura për secilin prej ofertuesve.

5.3 Pavlefshmëria dhe Mossuksesi i Procedurës Konkurruese;

Procedura konkurruese quhet e pasuksesshme kur:

- i) asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat e ftesës për procedurë konkurruese;
- ii) Autoriteti Kontraktues, për mungesë të leverdisë ekonomike të ofertave ose të vetë projektit, shpall mbylljen e procedurës konkurruese;
- iii) Ose kur nuk ka pjesmarrës në garë.

5.4 Veprimet e kundraligjshme

Në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues e refuzon një ofertë, nëse Ofertuesi që e ka paraqitur atë:

- i) i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues një dhuratë në para ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim, ose rrjedhën e procedurës së konkurrimit; dhe/ose
- ii) është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si psh – një ofertues është i lidhur me një person fizik ose juridik, që është ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues të japë shërbime këshilluese gjatë përgatitjes së projekteve,

specifikimeve ose dokumentave të tjerë lidhur me procedurën konkurruese, apo ka lidhje me anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- iii) Ka dorëzuar dokumenta/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura në Dokumentet Standarte të Procedures Konkurruese.

Autoriteti Kontraktues e informon me shkrim ofertuesin dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për refuzimin e ofertës, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e konkurrimit.

5.5 Percaktimi i Ofertuesit Fitues dhe Nënshkrimi i Kontratës

- 5.5.1** Pas përfundimit të afatit të ankimimit, të përcaktuar në Pikën 5.2.6, Autoriteti Kontraktues informon Ofertuesin, oferta e të cilit është përzgjedhur si më e mira, përmes dërgimit të Njoftimit të Fituesit, siç parashikohet në Formularin e Njoftimit të Fituesit. Një kopje e zgjeruar e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Para nënshkrimit të kontratës, Ofertuesi i përzgjedhur fitues duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues, Sigurimin e Kontratës në 10% të vlerës së projektit

Formulari i Sigurimit të Kontratës, siç parashikohet në Shtojcën 18, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet sipas pikës 5.5.3. Sigurimi i Kontratës mund të dorëzohet në formën e një i) garancie bankare e pakushtëzuar ose ii) nëpërmjet një policë sigurimi.

- 5.5.2** Autoriteti Kontraktues dhe Ofertuesi Fitues do të negociojnë në mirëbesim kushtet dhe afatet përfundimtare të Kontratës Koncesionare/Partneritetit Publik Privat, duke pasur parasysh se Ofertuesi Fitues do të kërkohet të nënshkruajë Kontraten Koncesionare sipas Kushteve të Veçanta dhe të Përgjithshme të Kontrates të nënshkruara nga ai në çdo faqe dhe të dorëzuar si pjesë e Ofertës Teknike-Financiare, të ndryshuara (nëse është e aplikueshme) gjatë procesit të negocimit të Kontratës Koncesionare/ Partneritetit Publik Privat.

- 5.5.3** Para nënshkrimit të kontratës bëhet e qartë se, nëse Ofertuesi Fitues (për arsye të pajustificuara) nuk do të dorëzojë Sigurimin e Kontratës dhe/ose nuk do të nënshkruajë Kontraten, Autoriteti Kontraktues do t'i mbajë Ofertuesit Fitues, Sigurimin e Ofertës dhe do të ftojë Ofertuesit e tjerë, sipas radhës në klasifikimin përfundimtar, deri sa të marrë Sigurimin e Kontratës dhe Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të nënshkruara në çdo faqe nga Ofertuesit sipas radhës, apo të refuzojë të gjitha Ofertat e mbetura.

- 5.5.4** Autoriteti Kontraktues do të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e Koncesionarit dhe termat kryesore të Kontratës Koncesionare, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 1

FORMULARI I OFERTËS

[Shtojce per tu paraqitur nga operatori ekonomik]

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Data: [Data e dorezimit]

* * *

Procedura e koncesionit/partneritetit publik privat: [Procedurë e hapur]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Forma e paraqitjes se ofertës përcaktohet si me poshtë:

Nr.	Kriteret	Njësia matëse	Oferta ose Referencën ne Ofertën Tuaj
1	Projekti dhe zgjidhja teknike		
2	Superstruktura		
3	Infrastruktura		
4	Logjistika e operimit të sigurisë së mjeteve		
5	Plani i Mirëmbajtjes		
6	Fee koncesionare	%	
7	Eksperiencia në Projektim	nr	
8	Ndikimi Social dhe Mjedisor		
9	Koha e ndërtimit	Muaj	

Vlera e Investimit (pa TVSH): _____

Shenim: Ofertuesi duhet te japë jo me tepër se një te dhënë per çdo kriter, bazuar kjo ne Projektin dhe plan biznesin e paraqitur prej tij.

Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Euro dhe Lekë sipas këmbimit valutor ditor të Bankës Shqiptare në ditën e publikimit të ftesës për ofertë

Kujdes ne formulimin e ofertës, s' duhet te ketë forma alternative te paraqitjes se saj

❖ **Bashkëlidhur një grafik punimesh si dhe preventivi përmbledhës**

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shtojca 2

FTESA PER OFERTE¹

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Puneve të mëposhtme:

“Për dhënien me konçesion/partneritet publik privat të portit turistik “Marina Vlorë”.

Vendi i kryerjes së kontratës së punës

Porti Marina Vlorë parashikohet të ndërtohet në qytetin e Vlorës dhe konkretisht në portin aktual të këtij qyteti.

Afati i ekzekutimit të kontratës – 35 vjet

Oferta duhet të paraqiten me mjete elektronike, përpara datës 26.2.2021 ora 14.00

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të web-it të APP-së, www.app.gov.al

¹ Kjo shtojcë është e aplikueshme për procedurën e kufizuar dhe procedurën me negociim me shpallje paraprake

Shtojca 3

[Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]
[Shtojce per tu paraqitur nga operatori ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e koncesionit/partneritetit publik privat [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi tërheq ofertën e tij gjatë procedurës konkurruese pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës;
- Ofertuesi nuk paraqet Sigurimin e Kontratës (në rast se shpallet fitues);
- Ofertuesi nuk nënshkruan kontratën koncesionare (në rast se shpallet fitues) brenda afateve kohore të specifikuar në Formularin e Njoftimit të Fituesit;
- Ofertuesi ka deklaruar të dhëna të rreme në ofertën e tij;
- Ofertuesi në rast se shpallet fitues refuzon pagesën e shpenzimeve sipas pikës 1.3 të DSPK

Ky Sigurim është i vlefshëm [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender] ditë nga data e mbarimit të afatit të dorëzimit të ofertave në faqen e internetit të APP-së.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

(Shënoni më poshtë informacinin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri faqes dhe pikat e DSK/PPP që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

Shtojca 5

[Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATE E PERMBUSHJES SË KËRKESAVE TË DOKUMENTAVE TË PROCEDURES KONKURRUESE TË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

E operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____

Une i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

Permbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e Koncesionit/Partneritetit publik Privat dhe i pranojmë pa rezerva dhe asnjë vërejtje ato. Deklarojmë nën përgjegjësinë tonë ligjore se jemi dakord me të gjitha specifikimet teknike të dhëna dhe i plotësojmë ato sipas përcaktimit në dokumentat e Koncesionit/Partneritetit publik Privat. Në përbushim të gjitha kërkesat ligjore, finansiare-ekonomike si dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat të procedurës konkurruese, dhe vërtetojmë këtë me certifikata dhe dokumenta, të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.

Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në dokumentat standarte për procedurën konkurruese.

Nuk do të marrim pjesë si ofertues në më shumë se një ofertë për këtë procedurë konkurruese.

Në autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/ dokumentat që i bashkëlidhën kësaj oferte.

Në rast se oferta jonë pranohet në do të bëjmë sigurimin e kontratës, sic parashikohet në dokumentat standarte të procedurës konkurruese.

Në rast se shpallemi fitues të procedurës konkurruese, biem dakord për të nënshkruar Kontratën sipas formularit të kushteve të kontratës.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6

[Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi konfliktin e interesave**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediae), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1,2 dhe 24 te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë “...bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es”.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet/partneritetin publik privat”.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojce per tu paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULAR VLERESIMI

(Ky formular do te shoqerohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti kontraktor/Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
VERTETOJ SE:	
Autoriteti kontraktor/Investitori ka nenshkruar kontraten me	
Emri i operatorit NUIS/ Bashkimit te operatoreve NUISET/ Nenkontraktoret NUISET	
Adresa/t	
Objekti i kontrates:	
Data e fillimit te kontrates	Data e mbarimit te kontrates
Vlera sipas kontrates	Vlera e realizuar
% e bashkimit te O.E. dhe pershkrimi i puneve te kryera nga secili anëtar	
Nenkontraktoret.	
Vleresimi	(shprehur me fjale)
	E permbushur
	E papermbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

Shtojca 8

[Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik:_____

Deklaroj se zoteron mjetet pajisjet teknike dhe asete te tjera fizike per te realizuar kontraten me objekt:_____

Ne pronesi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasise	Te tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit Te mjetit	Nr. Shasise Se mjetit	Nr. Kont se qerese (noterise)	Afati i kontrates qerese(Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojme autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhene ne kete table.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

**Nenshkrimi
Vula**

Shtojca 9

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) nuk është në proces falimentimi,
 - b) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - c) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional, të lëshuar nga Qendra Kombetare te Biznesit.

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrat Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 10 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kritere (pikat 1,2,) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këto kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas se ciles bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posacme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Sigurimi i ofertes, sipas Shtojces 3;
- b) Deklarate mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojces 5;
- c) Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojces 6;
- ç) Përshkrimi i Ofertës i plotësuar dhe nënshkruar në mënyrë të duhur, sipas Shtojces 1;
- d) Formular vleresimi sipas Shtojces 7;
- e) Deklarate mbi disponueshmerine e mjeteve sipas Shtojces 8

2. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar, ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë,

1. Regjistrimi si person juridik. Ekstrakt i regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
2. NUIS-i;
3. Dokument qe vërteton se kapitalet/asetet e subjektit tuaj nuk janë ne duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit ne qytetin ku keni selinë tuaj qendrore;
4. Dokument qe vërteton se subjekti juaj i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore;
5. Dokument qe vërteton se subjekti juaj i ka paguar te gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Administrata Tatimore;
6. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

Kriteret e mësipërme përmbushen vetëm nëse dokumentet e paraqitura janë origjinale ose fotokopje te noterizuara.

Shoqëritë ofertuese duhet te jene te regjistruara ne regjistrat përkatës profesionale ose tregtare te shtetit ne te cilin ato janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor. Për këtë ofertuesit duhet te dorëzojnë **Ekstraktin mbi historikun e subjektit te lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.**

Ofertuesi i huaj (shoqëri e regjistruar jashtë territorit te Shqipërisë) duhet te vërtetojë se i plotëson te gjitha kërkesat e renditura me sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur ne pikat përkatëse nuk lëshohen ne shtetin e origjinës te ofertuesit, atëherë ato do te pranohen ne formën e deklaratës me shkrim, nen përgjegjësinë e ofertuesit (sipas formës se paraqitur ne Shtojcën 12). Lidhur me deklarimin e mos lëshimit te këtyre vërtetimeve nga institucione te shtetit te origjinës, ofertuesit duhet te paraqesin vërtetim nga Dhoma e Tregtisë se vendit te origjinës - duke evidentuar faktin se ndonjë apo te gjitha vërtetimet e kërkuara ne këtë Shtojce nuk lëshohen nga ndonjë institucion publik përgjegjës. Sipas rastit, Autoriteti Kontraktues do te investigoje nëse këto vërtetime lëshohen apo jo nga institucionet përkatëse ne vendin e origjinës, dhe ne rast se konstaton zyrtarisht se ne shtetin e origjinës ekziston një institucion i cili mund te

lëshoj një vërtetim të tillë, të paraqitur nga ofertuesi i huaj në formën e vetë deklaramit atëherë Komisioni do të quaj të pavlefshëm dokumentin vetë deklarues të paraqitur.

Në rastet e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, kërkesat e Shtojcës 11 janë të detyrueshme për secilin prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Legalizimi i dokumentacionit

Dokumentet e siguruar jashtë territorit të Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të legalizuara në mënyrë që të kenë vlerë ligjore. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëritë që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 TETOR 1961) duhet të përmbajë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive

Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm.

Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

Përpara dorëzimit të ofertës, bashkimi i përkohshëm duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së secilit anëtar dhe elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi të përkohshëm. Vullneti për të hyrë në marrëveshje të bashkimit të përkohshëm të shoqërive duhet të jete i shprehur qartë me vendim të organit vendimmarrës të të gjitha shoqërive pjesëmarrëse në kontratën e bashkimit të përkohshëm. Për të vërtetuar se cili është organi vendimmarrës në këtë bashkim të përkohshëm shoqërisht, duhet të paraqitet statuti aktual i secilës prej shoqërive pjesëmarrëse në këtë bashkim të përkohshëm.

Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit caktojnë, me prokurë, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në procedurë në emër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.

Në rast se, bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkim.

Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet.

Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, i caktuar si përfaqësues i grupit dhe i

propozuar nga anëtarët e tjerë jo përfaqësues, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën, përndryshe, autoriteti kontraktor mund të tërhiqet nga kontrata. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, nëse përfaqësuesi i grupit nuk cakton një zëvendësues, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i grupit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

1.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të konkurrimit dhe mban përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, sic parashikohet apo nënkuptohet në Kushtet e Përgjithshme dhe të veçanta të Kontratës.

Në mënyrë që një ofertues të kualifikohet, ai duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Xhiro vjetore te secilit prej 3 (tre) viteve te fundit (vitet ushtrimore 2017, 2018 dhe 2019) të jetë të paktën sa 50% e investimit të përgjithshëm (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi.
2. Kapitali i Vet (totali i aktivitetit minus totalin e detyrimeve) i vitit të fundit ushtrimor (2019) të jetë të paktën sa 40% (dyzetë përqind) e vlerës së investimit të përgjithshëm (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi.
3. Aktivi i përgjithshëm i vitit të fundit ushtrimor (2019) të jetë të paktën sa 120% e investimit të përgjithshëm (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi.
4. Të paraqesë dokumente, në formën e një letre interesi, marrëveshje paraprake kreditimi ose çdo dokument tjetër, që vërtetojnë mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase apo të huaja në vlerë jo më pak se vlera e investimit të përgjithshëm (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi, për qëllime të realizimit vetëm të këtij projekti.

Dokumentet që provojnë burime të mjaftueshme financiare përfshijnë:

- a. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019), të paraqitura në administratën tatimore dhe,
- b. Raportet e auditimit financiar, (përfshirë opinionin e auditorit), të certifikuara nga një subjekt i jashtëm i licencuar auditimi dhe,
- c. Vërtetime të Xhiros vjetore të tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019) të lëshuara nga administrata tatimore, ku shoqëria ka selinë zyrtare.
- d. Dokumente të lëshuara nga institucione financiare të besueshme.

Struktura e Plan Biznesit

Plan biznesi, i paraqitur nga Ofertuesi për procedurën konkurruese, duhet të përmbajë minimalisht të dhënat e mëposhtme:

1. Kosto totale e Projektit (Vlera e investimit):
Shënim: Zëri i TVSH-së të paraqitet si zë i veçantë.
2. Mënyra e financimit (Burimet e Financimit):
__% e vlerës së investimit që do të financohet me kapitalin e vet;

- ___% e vlerës së investimit që do të finanohet me kredi.
3. Kushtet dhe grafiku i shlyerjes së kredisë:
Periudha e shlyerjes;
Norma e interesit;
Momenti i fillimit të shlyerjes së kredisë.
 4. Shpenzimet operative (shpenzimet vjetore që do të kryhen për mbarevajtjen e aktivitetit):
Shpenzime mirëmbajtje;
Shpenzime personeli;
Amortizimi vjetor.
 5. Të ardhurat:
Nga operimi i portit
Shërbime që lidhen direkt me aktivitetin kryesorë.
Shërbime të tjera ndihmëse në funksion të operimit të portit.
 6. Në bazë të treguesve të mësipërme të hartohen pasqyrat përkatëse:
Pasqyra “Të Ardhura dhe Shpenzime”,
Pasqyra “Cash - Flow” (lëvizja e parasë)
 7. Për përcaktimin e rentabilitetit të projektit të llogariten:
Treguesit e NPV – së;
Treguesit e IRR – së;
Periudha e veshlyerjes së investimit;
Grafiku i punimeve;

Kujdes:

1. Vlera e investimit e projektit nuk duhet të përlllogaritet nga ofertuesit me e vogel se 22,725,571 Euro pa TVSH, në të kundërt do të vepohet sipas shkronjës “ii” te pikes 2.1.2 tek “Udhëzimet per ofertuesit”
2. Koncesionari do të përballojë shpenzimet e supervizimit të punimeve të ndërtimit. Koncesionari duhet t’i paraqes Autoritetit Kontraktues të paktën tre propozime për përzgjedhjen e supervizorit. Autoriteti Kontraktues përzgjedh njërin prej supervizorëve të propozuar)

1.3. Kapaciteti teknik:

Ofertuesit duhet të plotësojë kërkesat teknike për kualifikim dhe të dorëzojë sa më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë ne mënyrë te detyrueshme dokumentacionin e nevojshëm që vërteton se ai vete ose një nga anëtarët e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, te kete realizuar me sukses punime civile në tre vitet e fundit me vlerë jo më të vogël se 50% e investimit (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi.
2. Licencat profesionale që lidhen me ekzekutimin e punimeve, si me poshtë:
 - a. Ku te përfshihen te paktën kategoritë:
 - NP-1 “Punime gërmimi ne toke”,
 - NP-2 “ Ndërtime Civile dhe Industriale”,
 - NP-3 “ Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada”,
 - NP-4 “Rrugë autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale”,
 - NP-7 “Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa vepra kullimi e vaditje”,

- NP-8 “Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë”
- NP-9 “Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime”,
- NP-10 “Ndërtimi i impianteve per prodhimin e energjisë elektrike”,
- NP-12 “Punime te inxhinierisë se mjedisit”,
- NS-2 “Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”,
- NS-4 “Punime rifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”
- NS-8 “Ndërtime parafabrikat, beton arme, struktura metalike dhe druri”,
- NS-9 “Punime strukturore speciale”,
- NS-10 “Shtresa dhe mbistruktura speciale”,
- NS-13 “Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni”,
- NS-14 “Impiante te brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.”,
- NS-15 “Pastrimi i ujerave detarë, liqenorë dhe lumorë”,
- NS-18 “Punime topogjeodezike”,
- NS-20 “Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje”

Operatorët ekonomike duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë bazuar në formatin e miratuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 date.16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kandidati/ofertuesi i huaj duhet të bëjë njehsimin e licencave profesionale të lëshuara nga vendi i origjinës për kategoritë e punimeve pranë Ministrisë përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë (mosparaqitja e saj përbën kusht kualifikues), sipas legjislacionit në fuqi.

3. Vlerësimi i kapacitetit teknik ne Projektim të Operatorit Ekonomik bazuar në dokumentet e mëposhtme:
Operatori ekonomik, duhet te plotesoje kriterin kualifikues te zerit “Projektim”. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një Licencë të vlefshme Profesionale. Operatori Ekonomik duhet të ketë një eksperience të provuar të dizejnimit dhe shpërndarjes së marinave të klasit botëror që i lejon ata të arrijnë njohjen e industrisë dhe akreditim ndërkombëtar.
4. Duhet te disponoje te paktën certifikatat e mëposhtme:
ISO 9001:2015 “Sistemi i Menaxhimit te cilësisë”
ISO 14001:2015 “Sistemi i Menaxhimit te mjedisit”
ISO OHSAS 18001:2007 “Sistemi i Menaxhimit te Shëndetit dhe Sigurisë ne pune”
ISO PAS 99:2012 “Sistemi i Menaxhimit te Integruar”
ISO 39001:2012 “Sistemi i Menaxhimit të sigurisë ne trafikun rrugore”
5. Mjetet, pajisjet teknike në dispozicion apo që mund të vihen në dispozicion të ofertuesit, sipas shtojcës ne DST.
6. Dëshmi për fuqinë punëtore te nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës,

Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 150 punonjës për periudhën Korrik 2018 – Nentor 2019.

Te paraqitet vërtetim për numrin e punonjësve dhe listëpagesat E-SIG 025 të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve vule të këtij institucioni.

Projekti duhet të përmbajë në mënyrë të detajuar studimet/raportet e mëposhtme:

- Përshkrimin e projektit, duke përfshirë por pa u limituar, me të dhënat teknike dhe zgjidhjen teknike, superstrukturen, infrastrukturen, logjistiken e operimit të sigurisë së mjeteve;
- Planin e mirëmbajtjes;
- Grafikonin e zbatimit të punimeve;
- Preventivin e punimeve;
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për objektin e konçesionit;
- Planin Biznesin sipas strukturës të percaktuar duke paraqitur dhe Vlerën e Fee Koncesionare të propozuar;

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën koncensionit/ppp që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktues _____ me objekt _____

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

KRITERET E VLERESIMIT

Ofertat do të vleresohen në baze të kriterëve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pike më tepër në baze të kriterëve të vleresimit.

Komisioni i Vlersimit të Ofertave do të vleresoje Ofertat Teknike dhe Financiare, në baze të kriterëve të mëposhtme:

Nr	Kriteri	Piket maksimale (P)	Formula e llogaritjes në pikë
1	<p>Përmbushja e kriterëve teknike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekti dhe Zgjidhja Teknike • Superstruktura (fasilitetet në funksion të shërbimeve që do të ofrohen klienteve) • Infrastruktura (tokësore, ujore, dallgethysi) niveli i tyre dhe kapaciteti i akostimit të sigurte të mjeteve. • Logjistika e operimit të sigurisë së mjeteve (hyrja, dalja dhe akostimi). 	<p>35 pikë</p> <p>(10 pikë);</p> <p>(10 pikë);</p> <p>(10 pikë);</p> <p>(5 pikë);</p>	
2	Plani i Mirëmbajtjes	15 pikë	
3	Fee Koncesionare	15 pikë	$P_{Fee} = \frac{Fee}{Fee_{max}} \cdot P$
4	Eksperiencia në Projektim	15 pikë	$P_{EP} = \frac{EP}{EP_{max}} * P$
5	<p>Ndikimi social dhe mjedisor:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndikimi social • Ndikimi mjedisor 	<p>(5 pikë)</p> <p>(5 pikë)</p>	
6	Koha e ndërtimit dhe vënies në shfrytëzim	10 pikë	$P_T = \frac{T_{min}}{T} \cdot P$
	Totali	100 Pikë	

Ku:

- P_T - Pikët e llogaritura të kohës së ndërtimit;
- T - Koha e ndërtimit
- T_{min} - Koha minimale e ndërtimit
- P - Pikët
- P_{Fee} - Pikët e llogaritura të vlerës së fee-së konçesionare
- Fee - Fee-ja konçesionare
- Fee_{max} - Fee-ja konçesionare maksimale
- P_{EP} - Pikët e llogaritura të eksperiencës në projektim
- EP - Numri i porteve te projektuara gjate 10 viteve te fundit
- EP_{max} - Numri maksimal i porteve te projektuara gjate 10 viteve te fundit

Kriteret e paraqitura në Ofertë përbëjnë kushte të panegociueshem të Kontratë Konçesionare dhe nuk mund të ndryshohen në asnjë rast.

Shpjegime për kriteret e përzgjedhjes se fituesit dhe metodologjinë e vlerësimit gjatë procedurës konkurruese:**Përmbushje e kriterëve teknike**

Do të vlerësohet me maksimumin e pikëve teknike ajo ofertë që do të shfaq zgjidhjen teknike me eficente.

Ofertuesi duhet të paraqesë projektin e detajuar ku të përfshihen dhe kriteret teknike për realizimin e portit.

Superstruktura është një pjesë e rëndësishme e projektit ku përfshihen dhe godinat e nevojshme për kryerjen e këtij aktiviteti dhe fasilitetet për shërbimet e ndryshme që do t'i ofrohen klientëve të protit gjatë kohës së qëndrimit me mjetet e tyre.

Infrastruktura është një komponent tjetër i rëndësishëm e projektit, e cila përbëhet nga pjesa tokësore ujore. Madhësia dhe niveli i tyre përcakton dhe kapacitetin e akostimit dhe nivelin e sigurisë së mjeteve gjatë operimit dhe akostimit në këtë port.

Plani i mirëmbajtjes

Zgjidhja e ofertuesit për periodicitetin dhe mënyrën e mirëmbajtjes në mënyrë të tillë që të sigurohet mirëmbajtja dhe garantohen standartet përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të projektit.

Vlera e “Fee konçesionare”

Është taksa (royalty) që konçesionari i paguan Autoritetit Kontraktues.

Ajo do të filloj të akumulohet që nga momenti i vënies në shfrytezim të portit. Vlera e saj shprehet me përqindje të të ardhurave mujore/vjetore që konçesionari do të krijoj dhe i jep Autoritetit Kontraktues.

Tarifa koncesionare minimale do të jetë 2 %, vlerë, e cila do të parashikohet në kontratë si një kusht i panegociueshëm i saj.

Mënyra e llogaritjes se pikëve do te jete ne baze te vleres që ofertuesi i jep çdo vit shtetit.

Eksperiencia në Projektim

Është eksperiencia ne projektim i ofertuesit per porte te ngjashme gjate 10 viteve te fundit.

Pikët maksimale do ti marrë ofertuesi i cili ka me tepër eksperience ne projektimin e porteve te ngjashme gjate 10 viteve te fundit dhe secili kandidat ofertues vlerësohet me anë të formulës së përcaktuar në Metodologjinë e Vlerësimit.

Ndikimi social dhe mjedisor i projektit

Do të vlerësohet me pikët maksimale paraqitja e një plani monitorimi të masave zbutëse në lidhje me ndikimin që shërbimi do të ketë në mjedis (flore, faunë, tokën, ujin, ajrin) si dhe në mikroklimën e ambientit..

Ofertuesi duhet të marrë përsipër shmangien ose zbutjen e impakteve sociale duke kryer një vlerësim të tyre duke shpjeguar dhe efektet që do të ketë projekti në komunitetin e zonës rreth Portit dhe një shpjegim se si projekti do ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin e zonës. Investime shtesë të parashikuara në ndihmë të infrastruktures së zonës

***Shënim:** Informacioni dhe çështjet që duhet të trajtohen në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis përshkruhen Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis“ si dhe ne kërkesat e tjera ligjore bazuar ne kuadrin ligjor rregullator te mjedisit. Megjithatë në raportin VNM mund të trajtohen edhe çështje të tjera të identifikuar gjatë plotësimit të saj.*

Koha e ndërtimit dhe e vënies në shfrytëzim të veprës

Është periudha nga çasti kur Kontrata e Konçesionit ka hyrë në fuqi deri në datën e aplikimit nga ana e koncesionarit për shpalljen si port ndërkombëtarë me Vendim të Këshillit të Ministrave konform Kodit Detar dhe legjislacionit ne fuqi. Ky afat përmban në total:

- i) Afatin e llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës së Konçesionit, që Konçesionarit do t'i duhet për t'u pajisur me të gjitha lejet e nevojshme lidhur me projektin e zbatimit të objektit të Kontratë Konçesionare. (Afati per Aplikimin per lejet e nevojshme eshte jo me shume se 12 muaj. Do te pezullohen te gjitha afatet ne momentin kur koncesionari aplikon prane enteve pergjegjëse për leje dhe licenca.) Afatin nga data kur Konçesionari ka aplikuar për të gjitha lejet e nevojshme për fillimin e punimeve deri në datën e aplikimit per shpalljen port nderkombëtar.

Kujdes!

Periudha më e vogël e prezantuar nga aplikantët në procedurën e konkurimit fiton pikët maksimale.

Koha e ofruar për ndërtim do të jetë pjesë e Kontratës së Konçesionit.

Vlerësimi i këtij kriteri do të realizohet sipas të cilës koha më e shkurtër (minimale) për ndërtimin e veprës merr pikët maksimale për këtë kriter dhe secili kandidat ofertues vlerësohet me anë të formulës së përcaktuar në Metodologjinë e Vlerësimit.

Shtojca 12

VETEDEKLARIM PËR OFERTUESIT **E HUAJ**

- Per pjesemarrjen ne proceduren per marrjen me koncesion/ppp te “_____”

[Date]

Per:

[Emri i Ofertuesit /Anetari Kryesues i Bashkimit te Perkohshem] deklaroj dhe garantoj qe, ne daten e kesaj letre [Emri i Ofertuesit /Anetari Kryesues i Bashkimit te Perkohshem] dhe cdo anetar i Bashkimit te Perkohshem (kur është rasti)

- (a) nuk i eshte nenshtuar procedurave te falimentimit ose likuidimit;
- (b) nuk eshte denuar per shkelje penale;
- (c) nuk eshte denuar me Vendim te Gjykates se Formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional;
- (d) kapitalet/asetet nuk po vleresohen nga Zyra e Permbarimit apo ekziston një urdhër sekuestroje për to;
- (e) ka përmbushur të gjitha detyrimet fiskale;
- (f) ka përmbushur të gjitha detyrimet e sigurimeve sociale.

Me respekt

Nenshkrimi i Personit te Autorizuar
Emri dhe Pozicioni i Nenshkruesit
Emri i Ofertuesit/Kryesuesit të Bashkimit të Përkohshëm
Adresa

Shtojca 13

(shtojce per tu plotesuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Kërkesat teknike të Projektit

Marina Vlorë duhet të sigurojë një vend-ankorim të mbrojtur, të sigurt, funksional gjatë gjithë vitit për flotat moderne të jahteve. Marina duhet të jetë e aksesueshme gjatë gjithë stinëve dhe duhet të sigurojë një kanal hyrjeje të sigurt dhe të lundrueshëm përveç basenit të mbrojtur.

Marina duhet të akomodojë minimalisht 400 anije. Ankorimet e llojeve të ndryshme të anijeve duhet të reflektojnë flotën tipike moderne që pritet të lundrojë në detet Jon dhe Adriatik, duke u mbrojtur gjithashtu kundër ndryshimeve të mundshme në tregje dhe karakteristika të anijeve.

Marina duhet të vendosë në dispozicion dhe të mirëmbajë infrastrukturë akomoduese dhe përpunuese për anijet turistike ekzistuese që operojnë aktualisht në Port dhe të konsiderojë rritjen / rënien e mundshme në këtë treg.

Duhet të sigurohet një vend për furnizimin me karburant të mjeteve lundruese, i cili të ketë pajisje ekologjike dhe të sigurt gjatë ofrimit të shërbimit.

Marina duhet të projektohet duke patur parasysh zhvillimin e qëndrueshëm dhe të synojë arritjen e akreditimeve përkatëse të eko-marinës të promovuara nga industria.

Marina duhet të projektohet në përputhje me Standardet Evropiane përkatëse dhe me kodet dhe udhëzimet përkatëse të zbatueshme në dizajnin e industrisë, ku të gjitha këto të jenë të referuara qartë.

Infrastruktura Detare

Marina duhet të sigurojë (por jo të kufizohet në) punët e mëposhtme civile dhe detare:

- Dallgëprirëse fikse për të siguruar mbrojtjen e duhur të basenit dhe infrastrukturës portuale;
- Sinjalistikën e nevojshme për operimin e sigurt të mjeteve lundruese sipas legjislacionit në fuqi;
- Vend furnizim karburanti bashkëlidhur pajisjet e sigurisë dhe funksionimit;

- Rindërtimi i plotë i Skelës Lindore;
- Punime thellimi për të arritur thellësinë e duhur të ujit të përfruar me skemën e përcaktuar të marinës;
- Ndërtesat operacionale të marinës;
- Infrastrukturën e nevojshme portuale;
- Shërbimin e ormexhimit të mjeteve lundruese.
- Qarkullimin e sigurt në zonë
- Rrjeti rrugor dhe lidhjet me zonën e brendshme
- Rrjetet e furnizimit të shërbimeve dhe lidhjet me rrjetin
- Infrastrukturën akomoduese për përpunimin e flotës ekzistuese të anijeve turistike
- Infrastrukturë emergjence për vizitat e superjahteve dhe anijeve lundruese.
- Sistemin e sigurisë portuale në zbatim të Kodit ISPS dhe ligjit nr. 168/2013 “Për sigurinë në anije dhe në porte”.
- Peisazh me hapësira publike dhe hapësira qarkullimi cilësore.

Objektet Operacionale

Marina duhet të sigurojë (por jo të kufizohet në) infrastrukturën dhe objektet operative të marinës, sic vijojnë më poshtë:

- Marrëveshjet dhe kontrollet adekuate të sigurisë
- Objektet e mbajtësve të ankorimeve.
- Objektet e menaxhimit të Marinës
- Objektet e autoriteteve (dogana, policia kufitare, kapitaneria, roja bregdetare)
- Parkim te përshtatshëm brenda marinës.
- Shërbimin e furnizimit të mjeteve lundruese me energji elektrike, ujë, wifi, tërheqjen dhe asgjësimin e ujërave të ndotura si dhe tërheqjen e mbetjeve të ngurta dhe vajore për secilën anije sipas legjislacionit në fuqi.
- Pajisjet dhe sistemet e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpëtimit si dhe ndaj emergjencave të tjera
- Hyrja në platformën ankoruese të Marinës dhe zgjidhjet e sigurisë.

Masterplani i Projektit dhe Materiali Mbështetës

Duhet të përgatitet një Masterplan për Marina Vlorë, i cili përshkruan paraqitjen e masterplanit të marinës dhe arsyetimin e dizajnit të kësaj paraqitjeje. Raporti i Masterplanit duhet të përmbajë planet dhe studimet e nevojshme mbështetëse që përshkruajnë arsyetimin mbi te cilin është ngritur dizajni.

Procesi mbi të cilin marina është hartuar (të përfshihen fazat e studimit dhe planifikimit) dhe është ndërtuar duhet të përshkruhet qartë në një deklaratë mbi metodologjinë. Rreziqet e projekteve duhet të identifikohen. Duhet të krijohen plane operative dhe mirëmbajtjeje.

Duhet të jepet një përshkrim i hollësishëm i punëve dhe instalimeve thelbësore, duke përfshirë dhe specifikimet.

Duhet të përgatitet një program zhvillimi.

Duhet të përgatitet një studim mbi ndikimin mjedisor dhe shoqëror.

Plani I Biznesit

Duhet të përgatitet një plan i hollësishëm biznesi për zhvillimin e marinës.

Shtojca 14

(shtojce per tu plotesuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 15

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të koncesionit/partneritetit publik privat. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike, nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar dhe VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u [s’kualifikuat] [eliminuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme [*shënoni kutinë e duhur*]:

[subjekti juaj]

- mori pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës, ose dosjen e tenderit, ose pjesë të tij, që u përdorën nga autoriteti kontraktor
- mori asistencë të paligjshme në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose një pjesë të saj

[subjekti juaj]

- Është gjykuar nga një gjykatë që gëzon juridiksionin kompetent se ka kryer një shkelje kriminale ose civile, që përfshin praktikat korruptive, pastrimin e parave, organizimin kriminal, në ligjet ose rregullat e zbatueshme në Shqipëri, ose sipas marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare;
- Një gjykatë me juridiksion kompetent ka vendosur se ka kryer një veprim mashtrimi ose një veprim të njëvlershëm me mashtrimin;
- Është në ndjekje penale për një nga veprat penale të përshkruara në nenin 45 të Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “ Per prokurimin publik”;

- ka falimentuar, aktiviteti është marrë nën administrimin e gjykatës, në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “ Per prokurimin publik”.
- është nën procedurën e deklarimit të falimentimit, sipas një urdhri për likuidim të detyruar ose administrim nga gjykata, ose sipas një marrëveshjeje me kreditorët, ose sipas procedurave të ngjashme, në pajtim me rregullat e prokurimit publik;
- është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarine profesionale;
- nuk ka paguar kontributet e sigurimit shoqëror, në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;
- nuk ka përmbushur detyrimet lidhur me pagimin e tatimeve, në përputhje me Ligjin Shqiptar ose me dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;

Nuk arritët të paraqisni:

- Çertifikatat ose vërtetimet e kërkuara që tregojnë se ju nuk jeni në kushtet e vendosura nga rregullat e prokurimit publik;
- Një çertifikatë, dokument ose vërtetime të tjera të mjaftueshme që kërkohen nga autoriteti kontraktor me qëllim verifikimin e përshtatshmërisë suaj profesionale;
- Vërtetime të mjaftueshme, siç përshkruhen në rregullat e prokurimit publik që tregojnë se kandidati ose ofertuesi në fjalë i plotëson kërkesat për kapacitetet minimale financiare, teknike dhe profesionale, të specifikuara në dosjen e ofertës ose në njoftimin e kontratës;
- Autoriteti Kontraktor ka vendosur se ju keni dorëzuar dokumenta që përmbajnë informacion të rremë, me qëllim kualifikimi;
- Oferta juaj [nuk i përgjigjet kërkesave] [është e parregullt];
- Nuk arritët të plotësonit kërkesat për sigurimin e ofertës;
- (ndonjë shkak tjetër përveç atyre më sipër)

JUSTIFIKIMI

[Jeni s’kualifikuar] [oferta juaj u refuzua] për shkak të këtyre arsyeve, si më poshtë:

[Shënoni arsyet e hollësishme për s’kualifikimin ose refuzimin e ofertës në fjalë]

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe VKM 575, date 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”. gjatë procedurës së koncesionit/ppp, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Ligjin“Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” .

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të koncesionit/ppp-ve.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 16

[Shtojce per tu plotesuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. _____ Vlera (me numra dhe fjale) _____

2. _____ Vlera (me numra dhe fjale) _____

Etj. _____ Vlera (me numra dhe fjale) _____

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. _____

2. _____

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

* * *

(Autoriteti Kontraktues) lajmëron [emri dhe adresa e Ofertuesit fitues] se oferta e paraqitur më datë [data] për marrjen me koncesion të [emri dhe përshkrimi i përgjithshëm i objektit të kontrates] është pranuar.

Afati i negociimit të Kontrates tuaj do të jete _____

Ofertuesi [emri] kërkohet t'i paraqesë (Autoriteti Kontraktues) dokumentet e meposhtme:

- Kopjen e vënies në dijëni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Vecanta të Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontrates sipas formes se kerkuar ne Dokumentat Standarte te Procedures Konkurruese. Sigurimi duhet te paraqitet jo me vone se ne momentin e nenshkrimit te Kontrates nga te dy palet.

Dokumenta të Procedures konkurrueser të Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

- Dokument bankar qe verteton pagesen e kryer per shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e konsulences se specializuar (*ne rast se ka*). Kjo pagese do te kryhet para fillimit te negociatave.
- Ne rast se terhiqeni nga lidhja e kontrates duhet te njoftoni me shkrim.

..... *Autoriteti kontraktues*

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Drejtuesi i Autoritetit Kontraktor]

Shtojca 17

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Punët**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
E
PËRFAQËSUAR
NGA**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**si Autoriteti Kontraktor
dhe
si Shoqëria Koncesionare
“.....” sh.p.k.**

**KONTRATË KONCESIONI/PPP
PËR
PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN DHE TRANSFERIMIN E NJË PORTI
TURISTIK NË QYTETIN E VLORËS**

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedures konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit te perzgjedhur si me i suksesshmi.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA PARAPRAKE

NENI 1 PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

1.2 Interpretime

NENI 2 KONCESIONI

2.1 Objekti i Koncesionit

2.2 Pranimi i Koncesionit dhe Shërbimet

2.3 Periudha e Koncesionit

2.4 Sipërfaqe e Portit

2.5 Deklarime dhe garanci

NENI 3 KRIJIMI I SPV

NENI 4 DATA EFEKTIVE E KONTRATËS

NENI 5 ÇËSHTJE FINANCIARE

5.1 Tarifa e Koncesionit

5.2 Tarifat e shërbimeve

5.3 Vlera e investimit

5.4 Mirëmbajtja

NENI 6 SIGURIMI I KONTRATËS

6.1 Sigurimi i Kontratës

6.2 Përgjegjësia e Koncesionarit

6.3 Penalitetet

6.4 Periudha e negocimit

6.5 Kthimi i një pjese të garancisë

NENI 7 KONCESIONARI DHE SHOQËRIA KONCESIONARE

NENI 8 NJËSIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT (NJZP)

NENI 9 NËN-KONTRAKTIMI DHE CEDIMI I KONTRATËS

NENI 10 SIGURIMET

10.1 Kërkesa për sigurim

10.2 Provat e mbulimit me Sigurim

10.3 Aplikimi i Procedurave të sigurimit

10.4 Vlefshmëria e mbulimit të siguracionit

NENI 11 DETYRIMET E PALËVE

11.1 Detyrimet e Koncesionarit

11.2 Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

NENI 12 Dorëzimi i objektit të koncesionit nga AK te koncesionari

NENI 13 GRAFIKU I PUNIMEVE

NENI 14 PROJEKTI

14.1 Shpenzimet e Projektit/Projekteve

14.2 Përgjegjësia për projektin dhe skicat

NENI 15 FAZA PARANDËRTIMORE

NENI 16 FAZA NDËRTIMORE

16.1 Fillimi dhe kohëzgjatja

16.2 Detyrimet e Koncesionarit gjatë fazës ndërtimore

16.3 Detyrimet e Autoritetit Kontraktues gjatë Fazës ndërtimore

16.4 Pezullimi i Punimeve të Ndërtimit

16.5 Braktisja e Punimeve

16.6 Detyrimet e Koncesionarit pas përfundimit të Fazës së Ndërtimit, Dërgimi i skicave, projekteve, vizatimeve dhe i materialeve teknike

16.7 Detyrime të tjera të Koncesionarit

16.8 Detyrime të tjera të Autoritetit Kontraktues

16.9 Shërbime të ndryshme (utilities) pikat e lidhjes

NENI 17 NDRYSHIME NE LIGJ

17.1 Ndryshim në Ligj

17.2 Sigurimi i Garancive të përshtatshme

NENI 18 SUPERVIZIMI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

NENI 19 SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA

19.1 Detyrimet e Koncesionarit

NENI 20 Objektet Arkeologjike ose objektet e Trashëgimisë Kulturore

NENI 21 FORCA MADHORE

NENI 22 RASTET E MOSPËRMBUSHJES

22.1 Rasti i Mospërmbushjes nga Koncesionari

22.2 Rasti i Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktues

22.3 Njoftimi për bisedime

22.4 Ndreqja e rasteve te mospërmbushjes

22.5 Detyrimet gjatë periudhës së ndreqjes

22.6 Të drejtat e palëve

22.7 Pasojat e mospërmbushjes

22.8 E drejta e Autoritetit Kontraktues për të zëvendësuar Koncesionarin

22.9 E drejta e Financuesit për te ndërhyrë dhe për të zëvendësuar Koncesionarin

22.10 Mos përmbushjet e Kontratës dhe shpërblimi i dëmit

NENI 23 ZGJIDHJA E KONTRATËS

23.1 Procedurat e zgjidhjes

23.2 Detyrime të tjera

23.3 Pasojat e përfundimit

23.4 Pasojat e zgjidhjes dhe detyrime të Koncesionarit

23.5 Pasojat e zgjidhjes së Kontratës për mospërmbushje me faj të Autoritetit Kontraktues

23.6 Pasojat e zgjidhjes së Kontratës për mospërmbushje të Koncesionarit

NENI 24 TRANSFERIMI ME PËRFUNDIMIN E KONCESIONIT

24.1 Fillimi i transferimit

24.2 Rakordimi i detyrimeve të ndërsjella në rast të përfundimit të Periudhës së Koncesionit

24.3 Vonesa në transferim

24.4 Risku

NENI 25 MJETET E NDREQJES, PENALITETE DHE DËMSHPËRBLIME

NENI 26 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 27 DISPOZITA TË FUNDIT

27.1 Veçimi

27.2 Ndryshimet e kontratës

27.3 Njoftimet

27.4 Konfidencialiteti

REPUBLIKA E SHQIPERISË

ZYRA E NOTERISË _____

NR. _____ **Rep.**

NR. _____ **Kol.**

**KONTRATË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PPP
PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
TRANSFERIMIN E NJË PORTI TURISTIK
NË QYTETIN E VLORËS**

PALËT:

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si ministria përgjegjëse për infrastrukturën (në vijim “**Autoriteti Kontraktor**”), përfaqësuar nga.....; dhe

2. **Shoqëria Koncesionare (SPV)**, “.....” sh.p.k., me numër identifikimi (NUIS):
.....me adresë në, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit
shqiptar, përfaqësuar nga

Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare do të referohen në këtë Kontratë secili si “**Pala**” dhe së bashku “**Palët**”, sipas varianteve të tyre gjuhësore në njëjës ose në shumës, siç mund ta kërkojë herë pas here konteksti i kësaj Kontrate.

Duke marrë parasysh që

A. Autoriteti Kontraktues ka tagrat të nënshkruajë këtë kontratë në përputhje me:

- Ligjin me nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënie me Koncesion/Partneritet Publik Privat” të ndryshuar;
- Vendimin nr.1, datë 14.10.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit Kombëtar sektorial të transportit detar dhe infrastrukturës portuale”
- Ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin Nr .9710, Datë 10.4.2007 “Për Portet Turistike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr.168/2013 “Për Sigurinë në anije dhe porte dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Konventën Ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes detare nga anijet (MARPOL

73/78);

- Ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi për supervizimin e punimeve të ndërtimit;
- Ligjin nr.107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala për zbatim të tij;
- Ligjin nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”
- Dokumentet e Procedurës Konkurruese “Për Dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat të Portit Turistik “Marina Vlore”;
- Ofertën e paraqitur nga ofertuesi i suksesshëm;
- Legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare me fuqi detyruese në Republikën e Shqipërisë.

B. Në datë....., ora, ofertuesi fituesi (koncesionari) ka paraqitur propozimin e tij në lidhje me këtë procedurë konkurruese (**“Oferta e Koncesionarit”**), e cila është pranuar nga Autoriteti Kontraktues (Komisioni i dhënies me koncesion);

C. Në datë, Autoriteti Kontraktues i ka dërguar Koncesionarit “Njoftimin e fituesit”, (*shkresa nr.....Prot. “Njoftim Fituesi”*), nëpërmjet së cilës është ftuar ofertuesi fitues (Koncesionari) për negocimin e Kontratës Koncesionare.

D. Autoriteti Kontraktues dhe koncesionari angazhohen në mirëbesim të vënë në zbatim këtë Kontratë Koncesioni në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara më poshtë:

DUKE PASUR PARASYSH sa më sipër, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime dhe Interpretime

1.1 Përkufizime

Kurdoherë që fjalët me gërmën e parë të madhe do të përdoren në këtë Kontratë (duke përfshirë edhe Anekset e saj) këto fjalë do të kenë kuptimet e përkufizuara më poshtë apo përgjatë tekstit të Kontratës:

- (i) **“Kontratë Koncesioni”** ose **“Kontratë”** do të thotë kjo Kontratë Koncesioni (bashkë me të gjitha Anekset e saj, të cilat do të konsiderohen pjesë përbërëse e pandashme e saj) dhe çdo dokument apo akt bashkëngjitur kësaj Kontrate ose Anekseve të saj, pavarësisht emrit që i jepet gjatë negociatave mes Palëve.
- (ii) **“Aneks”** do të thotë çdo shtojcë e kësaj Kontrate që formon një pjesë përbërëse dhe të pandarë të saj.
- (iii) **“Të Drejta Koncesionare”** do të thotë të drejtat e Shoqërisë Koncesionare duke

filluar nga Data Efektive për të kryer shërbimet e përcaktuara në këtë Kontratë.

- (iv) **“E Drejta për Kalim”** do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Port dhe në çdo pjese të tyre, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Kontrate.
- (v) **“Financues”** do të thotë çdo institucion i njohur financiar kombëtar apo ndërkombëtar, i cili në përputhje me veprimtarinë e tij mund të financojë këtë Koncesion bashkë me Shoqërinë Koncesionare.
- (vi) **“Instrument financiar”** do të thotë çdo marrëveshje huaje, bono, kontrata, instrumente, marrëveshje sigurimi, deklarata regjistrimi ose informimi, marrëveshje varësie, hipoteka, akte përfaqësimi e administrimi, marrëveshje kredie, marrëveshje për blerje bonosh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe dokumente të tjera që lidhen nga Koncesionari dhe/ose Shoqëria Koncesionare në lidhje me objektin e Koncesionit dhe për ushtrimin e të Drejtave Koncesionare, duke përfshirë modifikimet, plotësimet, shtesat, zgjatjet, ripërtëritjet dhe zëvendësimet e çdo financimi të tillë.
- (vii) **“Kërkesat Teknike të Projektimit”** do të thotë kërkesat teknike të projektimit në përputhje me legjislacionin për urbanistikën (Kërkesat Teknike të Projektimit);
- (viii) **“Kërkesat Teknike të Ndërtimit”** do të thotë kërkesat teknike të ndërtimit në përputhje me legjislacionin për urbanistikën (Kërkesat Teknike të Ndërtimit);
- (ix) **“Shoqëri Koncesionare”** është subjekti për qëllime të veçanta, i themeluar nga Ofertuesi fitues,për qëllim të veçantë të kësaj kontrate, së cilës do i kalojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.
- (x) **“Port”** do të thotë një pjesë e territorit tokësor të bregdetit, territorit detar, liqenor dhe ujqor, i përcaktuar për të pranuar mjete lundruese.
- (xi) **“Asete të Portit” ose “Asete”** do të thotë të gjitha të mirat materiale ose jo materiale të prekshme ose të paprekshme që janë ose do të krijohen nga Koncesionari të cilat janë të përfshira në Planin e Biznesit dhe Ofertën e Koncesionarit.
- (xii) **“Dokumente të Procedurës Konkurruese”** do të thotë i gjithë dokumentacioni i shpallur në datë....., në Agjencinë e Prokurimit Publik, tek i cili koncesionari u mbështet për të përgatitur Ofertën e vet. **(Aneksi 1)**
- (xiii) **“Oferta e Koncesionarit” ose “Oferta”** ka kuptimin e parashikuar në germën “B” të Deklarimeve Paraprake të Kontratës. **(Aneksi 2)**
- (xiv) **“Çmimi i Ofertës”** ka kuptimin siç përcaktohet në Ofertën e Koncesionarit.
- (xv) **“Data Efektive”/“Data e hyrjes në fuqi të kontratës”** ka kuptimin e përcaktuar në nenin 4 të Kontratës..
- (xvi) **“Punime Ndërtimi”**, do të thotë të gjitha punimet që nevojiten për ndërtimin e portit turistik në qytetin e Vlorës dhe facilitetet përkatëse.
- (xvii) **“Faza Para Ndërtimore”** do të thotë faza sipas përcaktimeve të Nenit 15 do të

thotë periudha kohore e cila do të llogaritet nga Data Efektive deri në datën e fillimit të punimeve të ndërtimit.

- (xviii) **“Faza e Ndërtimit”** do të thotë periudha e kohës që rrjedh nga Data e Fillimit të Punimeve deri në datën e përfundimeve të ndërtimit.
- (xix) **“Punime Mirëmbajtjeje”** do të thotë detyrimi i Koncesionarit, sipas kësaj Kontrate, për të kryer punime të tilla që janë të nevojshme për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e duhur të portit dhe të aseteve.
- (xx) **“Leje, Autorizim, Licencë”** do të thotë çdo miratim, leje, licencë, autorizim, aprovim ose certifikatë, nxjerrja ose ripërtëritja e secilës është në përgjegjësinë e çdo Entiteti Shtetëror dhe që kërkohet për zbatimin e kësaj Kontrate.
- (xxi) **“Shërbime”** do të thotë shërbimet objekt i kësaj kontrate siç përcaktohen në Nenin 2.2.2 më poshtë.
- (xxii) **“Tarifë Koncesionare”** do të thotë tarifa që Shoqëria Koncesionare i paguan Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të Shërbimeve dhe që rregullohet në Nenin 5.
- (xxiii) **“Tarifë Shërbimi”** do të thotë tarifën që aplikohen për çdo shërbim të kryer në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrit që mbulon transportet dhe Ministrit që mbulon financat, e përcaktuar në bazë të planit të biznesit paraqitur në konkurrimin e zhvilluar dhe që është pjesë e dokumentacionit të tenderit, që mund të ndryshojë në përputhje me këtë kontratë dhe Ligjeve.
- (xxiv) **“Vlera e Investimit”** do të thotë shuma totale për kryerjen e investimit për realizimin e projektit sipas objektit të kontratës.
- (xxv) **“Xhiro Vjetore”** do të thotë të ardhurat bruto vjetore që grumbullohen nëpërmjet mbledhjes së tarifave nga shërbimet që u ofrohen mjeteve lundruese në përputhje me legjislacionin në fuqi para pagesës së taksave në përputhje me legjislacionin shqiptar apo dhe ushtrimi i çdo aktiviteti tjetër që do të ushtrohet në Sipërfaqen e Portit në kuptim të nenit 2.1.2 të kësaj Kontrate.
- (xxvi) **“Aktet Korrutive”** do të thotë akti i premtimit, i dhënies, i marrjes ose i marrëveshjes për të marrë para ose ndonjë send tjetër me vlerë, me qëllim korrupcioni ose që perceptohet si korrupcion, për të ndikuar tek një punonjës publik në kryerjen e detyrave të tij shtetërore si dhe aktet që sjellin përgjegjësi penale sipas Kodit Penal Shqiptar.
- (xxvii) **“Praktikë e Mirë e Industrisë”** do të thotë praktikën, metodat, standardet, procedurat dhe rekomandimet që janë në përputhje me Ligjet e zbatuara përgjithësisht në ofrimin e Shërbimeve për sa i përket dhënies me Koncesion të këtij shërbimi, Koncesion i cili pritët në mënyrë të arsyeshme të realizohet nga një Kontraktor i aftë dhe me eksperiencë në rrethana të njëjta ose të ngjashme me praktika, metoda, standarde dhe procedura të cilat do të përfshijnë, pa kufizim, standardet shqiptare dhe evropiane (*cilado qofshin më të larta nga një*

periudhë kohore në tjetrën). Pa u kufizuar në to, në implementimin apo zbatimin e këtyre standardeve do të përfshihen aktet ligjore e nënligjore shqiptare dhe evropiane si në implementimin apo zbatimin e këtyre standardeve do të përfshihen aktet ligjore e nënligjore shqiptare dhe evropiane.

- (xxviii) **“Entitet Shtetëror”** ose **“Entitet”** do të thotë (i) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe/ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike dhe administrative e saj; dhe (ii) çdo entitet tjetër qeveritar, agjenci ose autoritet nën kontrollin e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike e saj, si dhe çdo komunë ose bashki, dhe që ushtrojnë juridiksion sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi subjektin për qëllime të veçanta (SPV), ose çdo autoritet i pavarur rregullator, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autoriteti Kontraktues përjashtohet nga ky përkufizim.
- (xxix) **“Ligjet”** do të thotë çdo akt ligjor e nënligjor duke përfshirë edhe legjislacionin ndërkombëtar me fuqi detyruese në Republikën e Shqipërisë, që zbatohen për këtë koncesion dhe që rregullon apo ndikon drejtpërsëdrejti apo tërthorazi në këtë Koncesion.
- (xxx) **“Taksë”** do të thotë çdo taksë, tatim, detyrim, tarifë, pagesë, taksë doganore ose tarifë e çdo lloji, e ngarkuar, e vendosur, e kërkuar, ose e mbledhur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo Entitet Shtetëror sipas Ligjeve.
- (xxxi) **“Periudhë Koncesionare”** do të thotë kohëzgjatja prej 35 (tridhjetë e pesë) vjetësh duke filluar nga Data Efektive, përveç kur Kontrata zgjidhet më parë ose shtyhet në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.
- (xxxii) **“Njoftim për Zgjidhje”** në lidhje me secilën Palë, sipas rastit, do të thotë një njoftim me shkrim i njëjës Palë drejtuar Palës tjetër që deklaron se do të ushtrojë të drejtën e saj për të filluar procedurat për zgjidhjen e kontratës.
- (xxxiii) **“Ditë Pune”** do të thotë çdo ditë e javës gjatë së cilës punohet, në kuptim të dispozitave të KP në Republikën e Shqipërisë.
- (xxxiv) **“Normë Inflacioni”** do të thotë norma zyrtare e inflacionit sipas përlllogaritjeve të INSTAT-it në momentin kur lind nevoja për referim tek kjo normë.
- (xxxv) **“Garanci e Kontratës”** do të thotë një sigurim i kontratës i vlefshëm përgjatë gjithë periudhës Koncesionare, i lëshuar nga një shoqëri sigurimi apo institucion bankar që vepron në Shqipëri në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që garanton përmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit.
- (xxxvi) **“Sipërfaqja e Portit”** do të thotë sipërfaqja sipas përcaktimit hartografik bashkëngjitur Kontratës në **Aneksin 3**.
- (xxxvii) **“Gjiri i Vlores”** do të thotë shtrirja gjeografike sipas përkufizimit, koordinatave dhe kufijve të përcaktuara në Gjeografinë Fizike.
- (xxxviii) **“Njësia e zbatimit të Kontratës”** do të thotë grupi që do të caktohet me

urdhër të Autoritetit Kontraktor për të ndjekur zbatimin e Kontratës.

(xxxix) “Test” do të thotë kryerja e verifikimeve të përputhshmërisë së ndërtimit të realizuar me lejen dhe projektin e miratuar.

1.2 Interpretime

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë:

- 1.2.1 Një njësi përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- 1.2.2 Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjane;
- 1.2.3 Referimi tek personat fizikë do të nënkuptojë edhe referimin tek personat juridikë të çdo lloj forme organizimi në kuptimin më të gjerë të mundshëm si dhe tek çdo lloj forme tjetër organizimi në kuptimin më të gjerë të mundshëm që nuk ka personalitet juridik;
- 1.2.4 Referimi tek një ligj, vendim, rregullore, urdhër apo procedurë përfshin referimin tek ai ligj, vendim, rregullore, urdhër apo procedurë siç është apo mund të jetë ndryshuar, shtuar kohe pas kohe dhe tek çdo akt tjetër i dalë në mbështetje e për zbatim të tyre.
- 1.2.5 Termat “*të kësaj*”, “*këtu*”, “*nëpërmjet kësaj ose nga kjo*”, “*në këtë*” dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Aneksi, Tabele, Bashkëlidhje ose Grafiku apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontrate;
- 1.2.6 Parathënia dhe Anekset, Tabelat dhe Bashkëlidhjet të kësaj Marrëveshjeje do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe referencat në Anekset, Tabelat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Anekset, Tabelat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate, përveç kur Palët bien dakord ndryshe;
- 1.2.7 Çdo frazë që fillon me fjalët “*përfshin*” ose “*duke përfshirë*”, “*në veçanti*”, “*për shembull*”, “*të tilla si*” apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të Kontratës;
- 1.2.8 Referencat në “*këtë Kontratë*” ose “*kjo Kontratë Koncesioni*” do të interpretohen si referenca në këtë Kontratë siç mund të ndryshohet ose modifikohet në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;
- 1.2.9 Sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri “*ditësh*” ky numër do t’i referohet ditëve kalendarike, përveç kur specifikohen si Ditë Pune;
- 1.2.10 Çdo referencë në “*muaj*” ose “*vit*” do të interpretohet si referencë në një muaj kalendarik ose në një vit kalendarik;
- 1.2.11 Çdo frazë, fjalë, term dhe/ose shkurtim që fillon me shkronjë të madhe i përdorur në ndonjë Aneks, Bashkëlidhje a Dokument tjetër bashkangjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në Kontratë;
- 1.2.12 Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nën paragrafët, Anekset dhe tabela e

përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e Kontratës;

1.2.13 Në rast mospërputhjeje midis çdo fjalë me germe të madhe, termi të përcaktuar, frazë ose shkurtime të parashikuara në Nenin 1.1 dhe një dispozite, fjale me germë të madhe, termi, fraze ose shkurtime parashikuar gjetkë në këtë Kontratë, Aneks, Bashkëlidhje ose në një Dokument tjetër bashkangjitur tek çdo Bashkëlidhje, kuptimi i dhënë në Nenin 1.1 do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në çdo Aneks, Bashkëlidhjeje a një Dokument tjetër bashkangjitur çdo Bashkëlidhjeje, përveç kur konteksti i kësaj Kontrate e kërkon ndryshe;

1.2.14 Një referim tek një Entitet Shtetëror nënkupton referimin tek juridiksioni i tij dhe nëse ky Entitet Shtetëror:

- (i) zëvendësohet nga një organ/ent tjetër, atëherë i referohet juridiksionit të këtij të fundit;
- (ii) pushon së ekzistuari, atëherë i referohet juridiksionit të Entit Shtetëror, i cili ka kompetenca të njëjta ose të përafërta me Entin Shtetëror që ka pushuar së ekzistuari;

1.2.15 Kudo në Kontratë, termi “*Koncesionar*” do të nënkuptojë njëkohësisht edhe termin Subjekti për qëllime të veçanta “*Shoqëri Koncesionare*” dhe anasjelltas;

1.2.16 Pa paragjykim ndaj paragrafëve të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet neneve dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojce të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër të cilit i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë, duke bërë interpretimin me mirëbesim, nisur nga qëllimi që kanë patur Palët:

- (i) Kjo kontrate
- (ii) Shtojcat e saj
- (iii) Dokumentacioni i ofertës
- (iv) Dokumentet e Procedurës së Tenderit;

1.2.17 Gjatë interpretimit kur ka mospërputhje mes dy neneve të Kontratës do të ketë përparësi neni që rregullon në mënyrë të posaçme çështjen e paqartë apo objekt mosmarrëveshjeje.

Neni 2

Koncesioni

2.1 Objekti i Koncesionit

2.1.1 Autoriteti Kontraktues nëpërmjet kësaj Kontrate dhe në përputhje me parashikimet e saj dhe me Ligjet, i jep Koncesionarit të drejtat Koncesionare për, ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e pronësisë në favor të shtetit, Autoritetit Kontraktor në përfundim të koncesionit, të një porti turistik “*Marina Vlorë*” në një pjese te territorit te portit aktual tregtar të Vlorës në

Vlorë, në përputhje me ofertën e paraqitur dhe të pranuar nga AK, si dhe me kushtet e kësaj kontrate.

2.1.2 Autoriteti Kontraktues nëpërmjet kësaj Kontrate dhe në përputhje me parashikimet e saj dhe me Ligjet në fuqi, i njej Koncesionarit mundësinë të ofrojë të gjitha llojet e shërbimeve të parashikuara në ofertën e paraqitur dhe të pranuar nga AK, si edhe shërbime mbështetëse të nevojshme për mirëfunksionimin e Portit, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

2.2 Pranimi i Koncesionit dhe Shërbimet

2.2.1 Koncesionari nëpërmjet kësaj Kontrate dhe në përputhje me parashikimet e saj e me ligjet pranon Koncesionin duke rënë dakord e duke marrë përsipër të zbatojë koncesionin. Koncesionari, në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate, Ligjet, Lejet, Autorizimet, Licencat e dhura dhe të kërkuara dhe me shpenzimet, kostot e nën riskun e tij, ka konceptuar dhe do të projektojë, financojë, ndërtojë, pajisë, mirëmbajë e shfrytëzojë dhe në fund të Periudhës Koncesionare do të transferojë pa kundërshtëpërblim pronësinë në favor të Shtetit, Autoritetit Kontraktor.

2.2.2 Shërbimet që do të ofrojë Koncesionari sipas kësaj Kontrate konsistojnë në:

-Parkim sezonal i verës

-Parkim i zgjatur dimëror

-Parkim i zgjatur vjetor

-Furnizim me karburant

-Ngarkim shkarkim te anijeve tregtare (mallrave) te tonazhit te vogël, te mesëm dhe te larte

-Furnizim me ushqime, ujë, etj.

-Shërbime mbështetëse të nevojshme për realizimin e objektit të kësaj kontrate.

-.....

2.2.3. Për çdo shërbim shtesë që nuk përfshihet në pikën 2.2.2 më lart, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktues, Koncesionari, do të drejtojë një kërkesë me shkrim Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të shqyrtojë dhe japë përgjigje për kërkesën e koncesionarit brenda 60 ditëve, në përputhje me rregullat dhe kushtet e përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, të ndryshuar.

2.3 Periudha e Koncesionit

2.3.1 Koncesioni i Portit turistik “Marina Vlore”, jepet për një periudhë prej 35 vjetësh nga hyrja në fuqi e saj (data efektive) dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të të datës efektive (periudha efektive). Megjithatë, në rastin e një zgjidhjeje përpara afatit 35 vjeçar, periudha e koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet te periudha që fillon nga data efektive dhe mbaron në datën e zgjidhjes. Në rastin e zgjatjes së koncesionit pas afatit 35-vjeçar, periudha e koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet te periudha që fillon nga data efektive dhe mbaron në datën e zgjatjes së afatit të periudhës koncesionare.

2.3.2 Afati kohor i Kontratës mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, për shkak të ndryshimeve të Kontratës, siç parashikohet në nenet 31, 32 dhe 33 të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin publik privat” të ndryshuar, por ndryshimi do të realizohet pasi Palët bien dakord me shkrim. Çdo ndryshim do të jetë në formën e një aneksi dhe do të ndjekë procedurën e përcaktuar në legjislacionin në fuqi

2.4 Sipërfaqja e Portit

2.4.1 Duke pasur parasysh që Koncesionari ka rënë dakord të përmbushë detyrimet e tij sipas parashikimeve të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues nëpërmjet kësaj Kontrate i njeh Koncesionarit të drejtën të hyjë, të marrë në dorëzim dhe të përdorë në përputhje me Ligjet dhe këtë Kontratë, Sipërfaqen e Portit, siç përcaktohet hartografikisht në Aneksin 3 me qëllim zbatimin e koncesionit në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.

2.4.2 Koncesionari nuk do të Përdorë Sipërfaqen e Portit, siç përcaktohet hartografikisht në Aneksin 3, për qëllime të tjera shtesë të paparashikuara në këtë Kontratë, pa miratimin me shkrim të Autoritetit Kontraktuesi cili jepet në çdo rast në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.4.3 Informacioni në lidhje me objektin e Koncesionit dhe sipërfaqen e portit (Asetet), prezumohen se janë siguruar në mirëbesim të plotë nga ana e Autoritetit Kontraktor, për të gjitha çështjet që lidhen me to. Autoriteti Kontraktor deklaron se do t'i sigurojë Koncesionarit nëpërmjet shoqërisë “Portit detar Vlore” sh.a., brenda një kërkesë dhe afati të arsyeshëm, çdo informacion që ka lidhje me Objektin e Koncesionit dhe Asetet e Portit, për të cilat Autoriteti Kontraktor ka informacion apo do të ketë dijeni në të ardhmen, për aq sa lidhet me këtë objekt.

2.4.4 Autoriteti Kontraktues nuk garanton gjendjen e Sipërfaqes së Portit (përfshirë hapësirën mbi tokë dhe atë nëntokësore apo nëndetare) për sa i përket kushteve të cituara më poshtë dhe Koncesionari pranon Sipërfaqen e Portit (përfshirë hapësirën mbi tokë dhe atë nëntokësore apo nëndetare) “siç është dhe ku është” dhe deklaron e pranon se:

- (i) ka inspektuar Sipërfaqen e Portit dhe zonën përreth tij dhe është dakord me gjendjen ekzistuese për sa i përket kushteve fizike, morfologjike, gjeo-fizike, gjeologjike dhe sizmike të Sipërfaqes së Portit (*mbi dhe nëntokësore apo nëndetare*);

- (ii) është dakord lidhur me përshtatshmërinë klimatike, hidrologjike, gjeologjike, sizmike, etj. si dhe me kushtet e përgjithshme gjeofizike të Sipërfaqes së Portit dhe zonës përreth në të cilën ndodhet kjo sipërfaqe, me tokën dhe nëntokën, pjesën nënujore, relievin dhe natyrën dhe me natyrën e dizenjove, punëve dhe materialeve që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;
- (iii) ka siguruar të gjithë informacionin e duhur lidhur me risqet, situatat apo problemet e papritura dhe të gjitha rrethanat që mund të ndikojnë apo cenojnë Koncesionarin dhe drejtat e tij apo që mund ta pengojnë apo vonojnë atë në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate.

2.4.5 Autoriteti Kontraktor garanton se Koncesionari do të posedojë dhe gëzojë i lirë dhe i qetë nga çdo pretendim i të tretëve, në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate, të gjithë Sipërfaqen e Portit (Asetet të përcaktuar në Aneksin 3) dhe çdo gjë që lidhet me to, përfshirë gjithë të drejtat që atij i lindin nga kjo Kontratë, përgjatë gjithë Periudhës së Koncesionit.

2.5 Deklarime dhe garanci

2.5.1 Koncesionari deklaron dhe garanton se:

- (i) disponon, brenda Datës Efektive, të gjithë informacionin e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, Dokumentet Standarde dhe të nevojshëm për zbatimin e koncesionit në afatet e përcaktuara në Kontratë, siç listohet në aneksin përkatës bashkëlidhur;
- (ii) zotëron apo do të zotërojë për realizimin në afat të koncesionit, të gjithë informacionin (*ligjor, ekonomik, teknik*), burimet financiare, pajisjet, sistemet dhe personelin e nevojshëm, të duhur dhe të kualifikuar për përmbushjen e Kontratës;
- (iii) Koncesionari deklaron dhe garanton se, në asnjë rast nuk do të kërkojë ndaj autoritetit apo Enteve shtetërore ndonjë dëmshpërblim, penalitet apo nuk do të ngrëjë çfarëdo lloj pretendimi padie në lidhje me zbatimin e kontratës për fakte, rrethana apo ngjarje për të cilat ka pasur, ka dijeni në mënyrë të shkruar ose referuar rrethanave prezumohet se duhet të kishte pasur dijeni;
- (iv) të gjitha kontratat që do të lidhen nga Koncesionari me të tretë nuk do të kenë periudhë vlefshmërie më të gjatë se data e përfundimit të Periudhës Koncesionare, në të kundërt përgjegjësi/debitor ndaj të tretëve lidhur me zbatimin e këtyre kontratave do të mbetet Koncesionari.
- (v) është themeluar dhe organizuar në mënyrë të vlefshme në përputhje me Ligjet si dhe gëzon të gjitha tagrat të ushtrorë të drejtat dhe të përmbushë detyrimet sipas kësaj Kontrate;
- (vi) ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura dhe gëzon të gjitha tagrat dhe kompetencat për të negociuar, lidhur, ekzekutuar dhe përfunduar këtë Kontratë dhe se kjo e fundit është angazhuese, detyruese, e vlefshme dhe e ekzekutueshme kundrejt tij;
- (vii) nuk ekziston asnjë akt, dokument dhe/ose veprim, i përfunduar, në proces e sipër dhe/ose pezull, para çdo gjykate, gjykate arbitrazhi, organi administrativ apo penal, etj., si dhe

nuk ka qenë subjekt i ndonjë gjobe, penaliteti, ndëshkimi, përgjegjësie civile apo penale që kanë ose mund të kenë efekt negativ me ndikim direkt në cënimin e përmbushjes së detyrimeve të Kontratës.

(viii) nuk është paguar nga ai apo për llogari të tij asnjë shumë në para apo çfarëdo lloj interesi ndaj çdo funksionari, punonjësi apo përfaqësuesi të Autoritetit Kontraktues me qëllimin për të influencuar ose për t'u përpjekur të influencojë tek ata për lidhjen apo për të përfituar avantazhe në lidhje me këtë Kontratë;

(ix) Gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit në rast se do të transferoje pjesët apo aksionet e Shoqërisë Koncesionare do ta bëjë sipas përcaktimeve në këtë kontratë.

x) Koncesionari garanton Autoritetin Kontraktues se i ka të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale (*nëse është rasti*) që nevojiten apo përdoren për përmbushjen e Kontratës.

(xi) t'i japë Autoritetit Kontraktues kopje origjinale (*ose vërtetim njësisë me origjinalin*) të policave së sigurimit që kërkohen nga kjo Kontratë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga lindja e detyrimit për t'u pajisur me to;

(xii) Për sa kohë që kontrata është në fuqi, do të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë shërbimet, pavarësisht pretendimeve që mund të ketë apo padive që mund të ketë ngritur ndaj Autoritetit Kontraktues dhe/ose të tretëve, në të kundërt Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën dhe sipas rastit të shpërblehet për dëmin e pësuar;

(xiii) Do të aplikojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për çdo leje, licencë apo autorizim, apo çdo miratim tjetër të nevojshëm për zbatimin e kësaj kontrate.

2.5.2 Autoriteti Kontraktues deklaron dhe garanton se:

- (i) I ka dhënë Koncesionarit të gjithë informacionin që disponon për zbatimin e kësaj Kontrate duke ofruar të japë, në përputhje me mundësinë, çdo informacion tjetër që mund t'i kërkohet nga Koncesionari pas Datës Efektive;
- (ii) Për ndërtimin e ndonjë porti tjetër turistik në zonën e Gjirit të Vlores do t'i përmbahet praktikave ndërkombëtare për portet turistike, vendimit Nr. 9, datë 18.06.2003 për "Zonat e zhvillimit të marinave kryesore, në mbështetje të turizmit të jahteve përgjatë hapësirës bregdetare shqiptare" të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 9710, datë 10.4.2007 "Për Portet Turistike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare me fuqi detyruese në Republikën e Shqipërisë si dhe Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin;
- (iii) Në përputhje me Ligjet në rast ndarje, bashkimi ose ndryshimi portofolesh, shprehja "Autoritet Kontraktues", sipas kësaj Kontrate do t'i referohet ministrit

- përgjegjës të ngarkuar për drejtimin e politikave të transportit detar në Republikën e Shqipërisë;
- (iv) Të gjitha të dhënat dhe i gjithë informacioni i janë vënë në dispozicion Koncesionarit në mirëbesim si të sakta, të vërteta dhe pa gabime;
 - (v) Do të asistojë Koncesionarin, në përputhje me fushën e përgjegjësisë shtetërore, gjatë procedurave për pajisje me Leje, Autorizime, Licenca(nëse do të jetë rasti), zonë e teknologjisë dhe e zhvillimit ekonomik, “duty free zone”, konform legjislacionit në fuqi;
 - (vi) Ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura dhe gëzon të gjitha tagrat dhe kompetencat për të negociuar, lidhur, ekzekutuar dhe përfunduar këtë Kontratë dhe se kjo e fundit është angazhuese, detyruese, e vlefshme dhe e ekzekutueshme kundrejt tij;
 - (vii) Asnjë urdhër, rregull/rregullore, vendim nuk do ekzekutohet nga Autoriteti Kontraktor në rast se ka një vendim pezullimi nga gjykata. Çdo mosmarrëveshje për veprimtarinë në port do të zgjidhet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 22 dhe 23 të kontratës;
 - (viii) Nëse Koncesionari në kuadër të strategjisë për zhvillimin e portit vendos për shtimin e shërbimeve dhe zgjerimin e portit me qëllim përmbushjen e kërkesave të kohës, ai duhet t’i paraqesë për miratim Autoritetit Kontraktues, Projektin dhe dokumentacionin përkatës. Autoriteti Kontraktues do të shqyrtojë dhe kthejë përgjigje për kërkesën e Koncesionarit brenda 60 diteve kalendarike, në përputhje me rregullat, kushtet dhe afatet e përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin publik privat” të ndryshuar.
 - (ix) Veprimtaria e portit nuk mund të ndalohet nga Autoriteti Kontraktues deri në përfundim të dorëzimit të portit, sipas mënyrës të parashikuar në këtë kontratë, me përjashtim të rastit kur provohet se Koncesionari, kryen veprimtari të jashtëligjshme, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e kësaj kontrate dhe vetëm nëse Gjykata është shprehur me Vendim të formës së prerë apo ka marrë vendim për sigurimin e padisë.

Neni 3 **Krijimi i SPV**

- 3.1 Koncesionari duhet ti japë Autoritetit Kontraktues kopje origjinale (*vërtetim njësia me origjinalin*) të dokumentacionit të krijimit/themlimit dhe regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV) si dhe të

ekstrakteve përkatëse brenda 30 (tridhjetë ditëve) nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate;

- 3.2 Nëse Koncesionari nuk ka përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 3.1 brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, vërtetuar në mënyrë të shkruar, do të jetë përgjegjës për t'i paguar Autoritetit Kontraktues penalitete në shumën 5,000 lekë për çdo ditë vonesë deri në përmbushjen e kushteve paraprake.
- 3.3 Nëse edhe pas 3 (tre) muajve nga afatet e përcaktuara në nenin 3.1 këto kushte nuk janë përmbushur, atëherë Palët do të bisedojnë për zgjidhjen e çështjes me pajtim nëpërmjet takimeve të njëpasnjëshme deri në arritjen e një përfundimi në mënyrë të shkruar.
- 3.4 Pas kalimit të 3 (tre) muajve të afatit 3 mujor të përcaktuar në nenin 3.3, faktuar në mënyrë të shkruar, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë Kontratën kundrejt një njoftimi paraparak prej 30 (tridhjetë) ditësh në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate dhe të mbajë sigurimin e kontratës.

Neni 4

Data Efektive e Kontratës

Pas nënshkrimit të kontratës nga palët, dhe miratimin e saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, kjo kontratë hyn në fuqi me botimin e vendimit të miratimit të saj, në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë (në vijim “data e hyrjes në fuqi”). Data Efektive e kësaj Kontrate do të jetë data e miratimit të kësaj kontrate nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Çështje Financiare

5.1 Tarifa e Koncesionit

5.1.1 Koncesionari detyrohet t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një Tarifë Koncesioni të barabartë më% (... përqind) të Xhiros Vjetore që Koncesionari do të grumbullojë nga Tarifat e aplikuara bazuar në deklaratimet financiare të kontrolluara të Shoqërisë Koncesionare për çdo Vit Financiar.

5.1.2 Detyrimi i Koncesionarit për pagesën e Tarifës së Koncesionit, fillon menjëherë me vënien në shfrytëzim të portit nga ana e Koncesionarit dhe paguhet me këste mujore brenda datës 15 (pesëmbëdhjetë) të muajit pasardhës.

5.1.3 Tarifat e Koncesionit të llogaritura të papaguara (të prapambetura) në datën e përcaktuar në këtë Kontratë do të paguhen pas kësaj date së bashku me një interes prej 0.1 % për çdo ditë vonesë llogaritur mbi pjesën e papaguar (e prapambetur). Nëse Koncesionari do të jetë në vonesë mbi 6 (gjashtë) muaj për të paktën një pagesë, Autoriteti Kontraktues njofton

ministrin përgjegjës për financat, urdhri i të cilit për arkëtimin e tarifës përbën titull ekzekutiv për bankat e nivelit të dytë ku ndodhet llogaria bankare e shoqërisë koncesionare që vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, si dhe ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha veprimet e lejuara nga ligji dhe kjo kontratë.

5.1.4 Me mbylljen e Vitit Financiar dhe certifikimin e bilancit Palët do të kryejnë rakordimet lidhur me Tarifën Koncesionare.

5.2 Tarifat e Shërbimeve

5.2.1 Koncesionari do të aplikojë Tarifën e përgjithshme siç e përmban oferta në **Aneksin 2**, pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Koncesionari do të paraqesë për miratim te Autoriteti Kontraktues tarifat e detajuara pas përfundimit të punimeve të ndërtimit dhe para shpalljes port i hapur për trafik ndërkombëtar.

Tarifat e Shërbimit mund të rishikohen, çdo vit bazuar në Normën e Inflacionit, sipas formulës në vijim:

$$IR = (NI^{(2)} - NI^{(1)})/NI^{(1)}$$

- “**IR**” do të thotë Indeksi i Rishikimit të Tarifave;

- “**NI⁽¹⁾**” do të thotë Norma e Inflacionit në fund të vitit në të cilin do të kryhet rishikimi i Tarifave ; dhe

- “**NI⁽²⁾**” do të thotë Norma e Inflacionit në vitin në të cilin do të kryhet rishikimi i Tarifave.

Do te merret për bazë Norma e Inflacionit e deklaruar në baza 3 mujore ose 6 mujore ose 9 mujore ose 12 mujore në varësi të Datës Efektive.

5.2.2 Shoqëria Koncesionare mund të rishikojë Tarifat e Shërbimit në rast se është e nevojshme për mbarëvajtjen e koncesionit, por në çdo rast do të njoftojë paraprakisht me shkrim të paktën 2 (dy) muaj përpara Autoritetin Kontraktues për tarifat e reja (të ndryshuara). Njoftimi i shkruar duhet të paraqesë dhe arsyet. Vendimmarrja për rishikimin e tarifave të shërbimit i përket Autoritetit Kontraktues, i cili brenda 30 ditëve do të arsyetojë, në mënyrë të shkruar, vendimin për zhvillimin e mëtejshëm.

5.3 Vlera e Investimit

Vlera që Koncesionari do të investojë në këtë Koncesion është
.....Lekë pa TVSH, sipas Aneksit 5.

5.3.1 Brenda periudhës së kësaj Kontrate, Koncesionari do të kujdeset të kryejë riinvestimet e duhura, sipas nevojave të veta, në fushat e mëposhtme:

1. Siguria Detare
2. Teknologjia e Administrimit Portual
3. Infrastruktura e shërbimeve turistike

4. Ngritja e kapaciteteve vendore në shërbime

5.4 Mirëmbajtja

Koncesionari, duke filluar nga momenti i shfrytëzimit të objektit të Koncesionit do të shpenzojë jo më pak se 1 % të shumës vjetore të grumbulluar nga Tarifat e Shërbimit, për mirëmbajtjen e portit dhe asetëve të tij, duke siguruar një menaxhim efikas dhe profesional të portit turistik “Marina Vlore” në Vlorë. Gjithashtu, Koncesionari duhet të respektojë Kodin Detar dhe Konventat Ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

Koncesionari, duke filluar nga momenti i shfrytëzimit të objektit të Koncesionit, duhet të mirëmbajë portin sipas standardeve në fuqi, duke siguruar një menaxhim efikas dhe profesional të portit për operimin më maksimal të tij. Gjithashtu, Koncesionari duhet të respektojë Kodin Detar dhe Konventat Ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

Koncesionari do kryejë riinvestimet e nevojshme në makineri e pajisje me qëllim dorëzimin e tyre në gjendje optimale pune në përfundim të periudhës së koncesionit dhe transferimit të veprës objekt koncesioni te Autoriteti kontraktues. Ky riinvestim do të bëhet bazuar në praktikën më të mirë të industrisë, si dhe në përputhje me kartën teknologjike të makinerive dhe pajisjeve të instaluara, duke garantuar Autoritetin Kontraktor për mirëfunksionimin e veprës brenda parametrave teknike, me transferimin tek ky i fundit.

Neni 6

Sigurimi i Kontratës

6.1 Sigurimi i Kontratës

6.1.1 Para nënshkrimit të kontratës, Koncesionari me qëllim përmbushjen e detyrimeve të kontratës gjatë gjithë periudhës koncesionare, i paraqet Autoritetit Kontraktues një sigurim kontrate të parevokueshëm dhe të pagueshëm me kërkesën e parë, në formën e një garancie bankare të pakushtëzuar, të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë në Shqipëri ose, në formën e një police sigurimi të pakushtëzuar, të lëshuar nga shoqëri sigurimi që operon në tregun e sigurimeve në Shqipëri.

6.1.2 Sigurimi Kontratës do të jetë në masën 5 % të vlerës së investimit. Dështimi për të dhënë sigurimin e kontratës në formën dhe vlerën e kërkuar, do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës së kontraktorit. Sigurimi i kontratës është aneks dhe pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj kontrate.

6.1.3 Koncesionarit i njihet e drejta të kërkojë tek autoriteti pas certifikimit të punimeve, me anë të një kërkesë me shkrim, të argumentuar dhe të shoqëruar me dokumente realizimi, reduktim të vlerës së sigurimit të kontratës, në mënyrë përpjesëtimore me realizimin e investimit në përputhje me grafikun e zbatimit të

kontratës dhe fazën përkatëse. Zbritja e Garancisë së Kontratës, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më e vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit të Kontratës.

6.2 Përgjegjësia e Koncesionarit

Koncesionari do të jetë përgjegjës për pagimin e primit përkatës për plotësimin e shumës së Garancisë së Kontratës sa herë që kjo shumë preket/ulet në përputhje me Kontratën për kryerje pagesash të çdo natyre të përcaktuar në këtë kontratë në favor të Autoritetit Kontraktues. Ky plotësim do të kryhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kryerja e ndonjë pagese të tillë.

6.3 Penalitetet

Nëse Koncesionari dështon të plotësojë brenda afatit të lartpërmendur shumën e Garancisë së Kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtën për të zbatuar dhe tërhequr një penalitet në shumën 10,000 lekë për çdo ditë vonesë, por gjithsesi jo më shumë se 3 (tre) muaj. Pas kalimit të 3 (tre) muajve Autoriteti Kontraktues do të kërkojë zgjidhjen me pajtim nëpërmjet takimeve të njëpasnjëshme deri në arritjen e një përfundimi në mënyrë të shkruar. Nëse palët nuk arrijnë një marrëveshje të shkruar sipas përcaktimeve të nenit 22 të kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues kundrejt një njoftimi paraprak prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh ka të drejtë të fillojë procedurat për zgjidhjen e kontratës sipas përcaktimeve të nenit 23 të kësaj kontrate.

6.4 Periudha e negociimit

Palët do të bisedojnë për zgjidhjen e çështjes me pajtim brenda një afati 30 ditor, me të drejtë zgjatje të këtij afati edhe për 30 ditë të tjera. Nëse Palët dështojnë të arrijnë një marrëveshje në përfundim të këtij afati Kontrata do të zgjidhet në përputhje me parashikimet e kësaj kontrate, përkatësisht neni 23.

6.5 Kthimi i një pjese të garancisë

Autoriteti Kontraktues, pas certifikimit të punimeve, me kërkesë të Koncesionarit do t'i kthejë këtij të fundit, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, një pjesë të vlerës së sigurimit të kontratës. Kjo masë mund të reduktohet në mënyrë përpjesëtimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më e vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit.

Neni 7

Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare

7.1 Koncesionari me qëllim zbatimin dhe përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate është i detyruar, sipas afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, të themelojë një subjekt për qëllime të veçanta (SPV) në përputhje me legjislacion shqiptar për Shoqëritë Tregtare, me shënimin para

emrit “Shoqëri Koncesionare”, të cilës i transferohen automatikisht të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate Koncesioni, nga momenti i njoftimit të AK për krijimin e Shoqërisë Koncesionare.

7.2 Pavarësisht krijimit të SPV, Shoqëria Koncesionare dhe Koncesionari do të jenë përgjegjës në mënyrë solidare për përgjegjësitë dhe detyrimet në përmbushjen e kushteve të kontratës, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, duke filluar që nga momenti i hyrjes në fuqi të kontratës.

7.3 Shoqëria Koncesionare do të themelohet duke pasur si ortakë/aksionarë shoqëritë që janë palë në kontratën e bashkimit të shoqërive të përzgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm.

7.4 Shoqëria Koncesionare do të ketë si objekt të vetëm objektin e kontratës së koncesionit.

7.5 Gjatë Periudhës Koncesionare, ortakët/aksionarët e Shoqërisë Koncesionare nuk do të transferojnë paketën kontrolluese të aksioneve në favor të ndonjë pale të tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues nuk mund të refuzojë pa shkaqe të arsyeshme ligjore dhe të argumentuara dhënien e këtij pëlqimi.

7.6 Koncesionari, me miratim të Autoritetit Kontraktues, vendos si garanci për financim në institucionet financiare, për realizimin e kësaj kontrate, vetëm te drejtat që rrjedhin nga kontrata e koncesionit.

Neni 8

Njësia e Zbatimit të Projektit (NjZP)

Brenda 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, me Urdhër të Ministrit të Autoritetit Kontraktues krijohet Njësia e Zbatimit të Projektit Koncesionar (“NjZP”) pranë AK. Përbërja dhe përgjegjësitë e NjZP do të përcaktohen në Urdhrin e Ministrit. Ky Urdhër nuk do të përmbajë detyrime të Koncesionarit ndaj NjZP. Puna e NjZP do të vazhdojë gjatë gjithë Periudhës Koncesionare.

Neni 9

Nënkontraktimi dhe cedimi i Kontratës

9.1 Autoriteti kontraktues mund:

- a. t'i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30 % (tridhjetë përqind) e vlerës totale të kontratës së koncesionit te palët e treta, duke siguruar, në të njëjtën kohë, një mundësi për tenderuesit që ta rrisin këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit;
- b. të kërkojë nga tenderuesit që të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e vlerës totale të kontratës që ata planifikojnë t'u caktojnë palëve të treta.

9.2. Për nënkontraktimin e partneriteteve publike private, që realizohen si kontrata të punëve publike ose të shërbimit publik, zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, në përputhje me rrethanat.

Neni 10

Sigurimet

10.1 Kërkesa për sigurim

Koncesionari me shpenzimet e veta duhet të paguajë sigurim për aktivitetet konform standardeve ndërkombëtare për operimin e porteve si dhe menjëherë pas pagimit të këtyre sigurimeve të informoj Autoritetin Kontraktues për to.

10.2 Provat e Mbulimit me Sigurim

Koncesionari në mënyrë periodike duhet t'i vërë në dispozicion Autoritetit Kontraktues kopje të policave të sigurimit të marra nga Koncesionari në përputhje me këtë Kontratë.

10.3 Aplikimi i Procedurave të Sigurimit

Të gjitha shumat monetare të marra nga sigurimet sipas pikës 10.1 duhet të përdoren menjëherë nga Koncesionari për riparimin, rinovimin, restaurimin ose zëvendësimin e aseteve ose të ndonjë pjese të tyre që mund të jetë dëmtuar ose shkatërruar dhe kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme.

10.4 Vlefshmëria e Mbulimit të Siguracionit

Policat e Sigurimit duhet të jenë të vlefshme dhe në fuqi gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës plus 30 ditë pas përfundimit të saj. Çdo policë sigurimi duhet të parashikojë që nuk përfundon ose anulohet më herët se 10 (dhjetë) ditë nga dita kur një përfundim apo anulim i tillë i është njoftuar Autoritetit Kontraktues me shkrim.

Neni 11

Detyrimet e Palëve

11.1 Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari ka detyrim:

- 11.1.1** të sigurojë maksimumi brendamuajve nga data e hyrjes në fuqi apo para marrjes së dokumentit të ndërtimit (nëse momenti i pajisjes me leje ndërtimi nëse ky ndodh para afatit në fjalë), të gjithë burimet e nevojshme financiare apo të çdo lloji dhe natyre tjetër të kërkuara për përmbushjen e Kontratës;
- 11.1.2** të njoftojë Autoritetin Kontraktues, brenda 10(dhjetë) ditëve, për çdo ndryshim thelbësor në burimet e financimit duke i paraqitur në të njëjtën kohë Autoritetit Kontraktues dokumente provues dhe propozime se si do të zgjidhet situata financiare.
- 11.1.3** të punësojë/kontraktojë persona të aftë profesionalisht për ofrimin e Shërbimeve, në përputhje me Ligjet, Kontratën dhe Praktikën e Mira të Industrisë;

- 11.1.4** të marrë masat për të garantuar sigurinë në territorin ku do të ushtrorë aktivitetin dhe do të ofrojë Shërbimet;
- 11.1.5** të lejojë Autoritetin Kontraktues të monitorojë dhe kontrollojë përmbushjen e Kontratës nëpërmjet komisionit NJZP të ngritur për këtë qëllim sipas një njoftimi paraprak 3 ditë pune para ditës së caktuar për monitorim dhe kontroll;
- 11.1.6** të përmbushë, me shpenzimet e kostot e veta çdo punim shtesë për të korrigjuar defektet apo mangësitë e konstatuara nga Autoriteti Kontraktues dhe do të sigurojë përfundimin në kohë të Projektit/Infrastrukturës dhe Shërbimeve të Projektit sipas parashikimeve të kësaj Kontrate;
- 11.1.7** të zbatojë legjislacionin në fuqi gjatë veprimtarisë së tij. Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare do ushtrorë kujdes të veçantë për: respektimin e legjislacionit mjedisor lidhur me ndotjen e mjedisit detar, ajrit, tokës, emetimin e zhurmave etj., Kodin e Punës dhe rregulloret e sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe të sigurimit nga zjarri, uji etj., për të parandaluar çdo aksident, fatkeqësi apo dëm në punë; të mos cënuar operacionalitetin, sigurinë dhe gatishmërinë e Forcave të Armatosura/Forcave Detare, si dhe ushtrimin e sovranitetit dhe zbatimin e ligjshmërisë në det.
- 11.1.8** do të përballojë vetë të gjitha kostot apo shpenzimet e nevojshme për riparime apo zëvendësime të pajisjeve që përdoren për përmbushjen e Kontratës.
- 11.1.9** Koncesionari duhet që gjatë Periudhës së Koncesionit të paguajë në mënyrë të rregullt: Tarifën Koncesionare, taksat, tatimet, detyrimet, TVSH-në, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të të punësuarve, borxhet apo tatimin mbi të ardhurat, detyrimet për taksat indirekte, detyrimet doganore, taksat e shërbimeve të cilat mund të vilen, të merren ose të përfitohen në çdo kohë nga çdo Ent apo Organ Shtetëror duke përfshirë, në zbatim të Infrastrukturës dhe Shërbimeve të Projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- 11.1.10** të përballojë vetë të gjitha shpenzimet apo kostot që lidhen me shpërblime dëmsh që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta.
- 11.1.11** të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra si dhe shpenzimet noteriale.
- 11.1.12** Koncesionari të lejojë kalimin e qetë të mjeteve lundruese që do të përdorin pjesë të tjera të gjirit jashtë objektit të koncesionit, të cilat nuk pengojnë aktivitetin e Portit dhe të jetë në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet/rregulloret/urdhurat përkatës në fuqi.

11.2 Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues, përveç çfarë mund të përshkruhet në dispozitat e tjera të Kontratës, ka detyrim:

- 11.2.1** Të pajisë Koncesionarin me Lejet, Autorizimet, Licencat që janë kompetencë e tij dhe enteve në varësi të tij, në rast se aplikimi nga koncesionari për marrjen e tyre, është i plotë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;

11.2.2 Të asistojë Koncesionarin, në përputhje me fushën e tij të përgjegjësive, për pajisjen me Lejet, Autorizimet, Licencat që janë kompetencë e Enteve Shtetërore;

11.2.3 Autoriteti kontraktues merr përsipër të sigurojë vazhdimësinë e kontratës për sa është e mundur, pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtare dhe të sektorit.

11.2.4 Të asistojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate;

Neni 12

Dorëzimi i objektit të koncesionit nga AK te koncesionari

Autoriteti kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës/data efektive e saj, duhet të siguroje se nëpërmjet Portit detar Vlore do të behet dorëzimi i nje pjese te sipërfaqes objekt të kësaj kontrate tek koncesionari dhe pjesa tjetër do ti jepet ne dorëzim pas përfundimit të financimit dhe realizimit të projektit në Portin e Triportit, zhvendosjen e Portit Detar Vlore ne Triport Vlore ne menyre qe te bëhet e mundur kryerja e procedurës së zhvendosjes së operacioneve të përpunimit të mallrave nga porti aktual i Vlorës në drejtim të portit të Triportit Vlorë. Data e dorëzimit fillestar do të konsiderohet data e dorëzimit të objektit.

Neni 13

Grafiku i Punimeve

Koncesionari do ta realizojë investimin në përputhje me Grafikun e Punimeve të parashikuar në **Aneksin 4** dhe sipas afateve të përcaktuara në të.

Neni 14

Projekti

14.1 Shpenzimet e projektit/projekteve

Koncesionari, me shpenzimet dhe kostot e veta, do të përgatisë të gjitha Projektet në përputhje me kërkesat e këtij Projekti Koncesioni dhe legjislacionin, përfshirë këtu Kërkesat Teknike të Projektimit (“KTP”).

14.2 Përgjegjësia për projekttime dhe skicat

Koncesionari do të jetë përgjegjësi i vetëm për përputhshmërinë e projektit/projekteve dhe skicave të këtij Koncesioni me Ligjet dhe merr përsipër të shpërblejë çdo dëm të rrjedhur për gabime në projektim.

Neni 15

Faza Parandërtimore

15.1 Koncesionari do të kryejë në përputhje me ofertën:

- (i) mbledhjen e të dhënave në terren brendaditëve nga Data Efektive.
- (ii) përpunimi i të dhënave, realizimi i modelimit dhe përgatitja e raportit paraprak brendaditëve nga përfundimi i afatit paraardhës në rast se nuk ka nevojë për informacion shtesë të cilin ia kërkon Autoritetit Kontraktues;
- (iii) hartimi i projektit të detajuar dhe preventivit përfundimtar brenda ditëve nga përfundimi i afatit paraardhës;
- (iv) hartimi i raportit të ndikimit në mjedis, me qëllim marrjen e lejes mjedisore dhe paraqitja e dokumentacionit të plotë në përputhje me legjislacionin për marrjen e lejes së ndërtimit brendaditëve nga përfundimi i afatit paraardhës.

15.2 Koncesionari detyrohet të paguajë një penalitet në shumë prej 10,000 leke për çdo ditë vonesë në ekzekutimin e detyrimeve të mësipërme, pa shkak të ligjshëm.

Neni 16

Faza Ndërtimore

16.1 Fillimi dhe Kohëzgjatja

Koncesionari brendaditëve nga pajisja me të gjitha Lejet, Autorizimet, Licencat përkatëse të nevojshme, do të fillojë punimet dhe, brendamuajve siç përcaktohen në **Aneksin 4**, do të realizojë Punimet e Ndërtimit. Faza Ndërtimore do të konsiderohet si e përfunduar në përputhje me Kontratën pasi Koncesionari të jetë pajisur me Lejen e Shfrytëzimit në përputhje me Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Për çdo ditë vonesë në fillimin e Punimeve të Ndërtimit pas ditës sënga pajisja me Lejet, Autorizimet, Licencat përkatëse, Koncesionari detyrohet të paguajë një penalitet ditor në shumën 10,000Lekë.

Për çdo ditë vonesë në përfundimin e Punimeve të Ndërtimit pas kalimit të afatit të parashikuar në Ofertë, Koncesionari detyrohet të paguajë një penalitet ditor në shumën 10,000 Lekë, përveç kur vonesa ka ardhur për arsye objektive, të njohura nga AK. Afati, kundrejt një shkrese njoftuese nga Koncesionari për Autoritetin Kontraktor ku shpjegon arsyet, do të pezullohet për aq kohë sa Entet Shtetërore vonohen në pajisjen e Koncesionarit me Lejet, Autorizimet, Licencat përkatëse tej afatit ligjor për dhënien e tyre, me kushte që Koncesionari të ketë paraqitur në afat dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik për pajisjen me to.

16.2 Detyrimet e Koncesionarit gjatë Fazës Ndërtimore

Krahas detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Kontratë, gjatë Fazës Ndërtimore Koncesionari:

- 16.2.1 do të sigurojë në kohë të gjithë burimet e nevojshme financiare apo të çdo lloji tjetër të kërkuara për realizimin në afat të detyrimeve kontraktore;
- 16.2.2 do të punësojë/kontraktojë persona profesionalisht të aftë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e objektit të Koncesionit dhe asetëve të tij dhe do të sigurojë që të gjitha Punimet e Ndërtimit janë kryer në përputhje me Kërkesat dhe Teknike të Projektimit dhe Kërkesat Teknike të Ndërtimit (“KTN”);
- 16.2.3 do të njoftojë Autoritetin Kontraktues, brenda ditëve, për çdo ndryshim thelbësor në burimet e financimit duke i paraqitur në të njëjtën kohë Autoritetit Kontraktues dokumente provues dhe propozime se si do të zgjidhet situata financiare.
- 16.2.4 do t’i japë përparësi sigurisë gjatë veprimtarisë ndërtimore dhe shfrytëzuese me qëllim mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe mjedisit;
- 16.2.5 do t’i sigurojë përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktues, në kohë të arsyeshme kundrejt një njoftimi paraprak prej këtyre të fundit dërguar jo me pak se 3 ditë para, akses në kantier me qëllim që të verifikojnë ecurinë në ndërtim për përmbushjen e detyrimeve të Kontratës. Për të shmangur çdo paqartësi, mos inspektimi nga Autoriteti Kontraktues i çdo/ndonjë Punimi Ndërtimi:
- (a) nuk do të konsiderohet si pëlqim apo miratim i Autoritetit Kontraktues dhe as si heqje dorë e tij nga të drejtat që ai ka sipas kësaj Kontrate, dhe
 - (b) nuk do ta përjashtojë apo shkarkojë Koncesionarin nga detyrimet apo përgjegjësitë sipas kësaj Kontrate lidhur me Punimet e Ndërtimit;
- 16.2.6 do të paraqesë raporte gjashtë mujore mbi ecurinë e Punimeve të Ndërtimit apo çdo informacion të nevojshëm në lidhje me objektin e kësaj Kontrate, që mund të kërkohej nga Autoriteti Kontraktues;
- 16.2.7 do të përmbushë, me shpenzimet e kostot e veta çdo punim shtesë që mund të jetë i nevojshëm për të korrigjuar defektet apo mangësitë e konstatuara nga Autoriteti Kontraktues dhe do të sigurojë përfundimin në afat të Fazës Ndërtimore;

16.3 Detyrimet e Autoritetit Kontraktues gjatë Fazës Ndërtimore

Krahas detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Kontratë, gjatë Fazës Ndërtimore, Autoriteti Kontraktues:

- 16.3.1 Do të japë Licencat, Lejet, Autorizimet dhe miratimet e pëlqimet e kërkuara sipas kësaj Kontrate të cilat janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktues, me kusht të plotësisimit të dokumentacionit të plotë, në përputhje me afatet ligjore

dhe do bëjë të gjitha përpjekjet për ta asistuar Koncesionarin në funksion të ecurisë normale të Fazës Ndërtimore;

16.3.2 Me kërkesë me shkrim nga ana e Koncesionarit, do ta asistojë këtë të fundit, duke bërë të gjitha përpjekjet, me qëllim marrjen nga institucionet përkatëse të të gjitha lejeve të punës apo lejeve të qëndrimit për personelin e huaj të kontraktuar apo të punësuar (nëse ka) për zbatimin e Projektit si dhe të ndonjë leje apo autorizimi tjetër që mund të kërkohe në këtë aspekt.

16.4 Pezullimi i Punimeve të Ndërtimit

16.4.1 Autoriteti Kontraktues, pasi ta ketë njoftuar për këtë qëllim, ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të pezullojë plotësisht apo pjesërisht Punimet e Ndërtimit nëse sipas gjykimit të arsyeshëm dhe të faktuar të Autoritetit Kontraktues, punimet që janë kryer apo po kryhen nuk janë në përputhje me legjislacionin dhe veçanërisht KTP, KTN dhe/ose standardet e sigurisë, pretendime të faktuara shkresërisht nga Autoriteti Kontraktues.

16.4.2 Koncesionari, me marrjen e njoftimit sipas nenit 16.4.1, do të pezullojë Punimet e Ndërtimit apo pjesë të tyre për kohëzgjatjen dhe në mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues dhe pasi ta këtë bërë këtë do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues, masat korrigjuese/rehabilituese për të rregulluar defektet që i janë sjellë në vëmendje.

16.4.3 Pas marrjes së masave të nevojshme, dhe kërkesës me shkrim të Koncesionarit për revokimin e pezullimit, Autoriteti Kontraktues do të heqë masën e pezullimit me shkrim, jo më vonë se 3 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës së Koncesionarit.

16.4.4 Çdo mosmarrëveshje lidhur me pezullimin e punimeve, revokimin e pezullimit apo me masat korrigjuese/rehabilituese të propozuara do të zgjidhet në përputhje me këtë Kontratë.”.

16.5 Braktisja e Punimeve

Koncesioni do të konsiderohet i braktisur nga Koncesionari nëse, pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, Koncesionari:

16.5.1 njofton Autoritetin Kontraktues për vendimin e tij për të braktisur pa shkak të ligjshëm plotësisht ose pjesërisht Punimet;

16.5.2 nuk rifillon plotësisht ose pjesërisht Punimet e Ndërtimit brenda ditëve nga mbarimi i Rastit apo Ngjarjes së Forcës Madhore dhe rikthimit të

situatës në normalitet; ndërpret plotësisht ose mbi 50 % të Punimeve të Ndërtimit që duhen kryer kohë pas kohe për një periudhë prej të paktën.....; tërheq apo largon nga kantieri drejtpërdrejt ose nëpërmjet veprimeve të nënkontraktorëve, të gjithë personelin e domosdoshëm për kryerjen e Punimeve të Ndërtimit, para përfundimit të Punimeve të Ndërtimit me kusht që kjo tërheqje të çojë në një ndërprerje thelbësore të Punimeve të Ndërtimit.

16.5.3 Data e braktisjes ose e të konsideruarit të braktisur do t'i korrespondojë:

- (i) në rastin e parashikuar në pikën 16.5.1 më sipër, datës së njoftimit;
- (ii) në rastet e parashikuara në pikën 16.5.2, ditës që vjen menjëherë pas datës, në të cilën kanë përfunduar afatet ditore i parashikuar;
- (iii) në rastin e parashikuar në pikën 16.5.3 më sipër, datës kur personeli efektivisht tërhiqet/largohet nga kantieri.

16.6 Detyrime të Koncesionarit pas përfundimit të Fazës Ndërtimore

Dërgimi i skicave, projekteve, vizatimeve dhe i materialeve teknike

16.6.1 Jo më vonë semuaj pas përfundimit të Punimeve të Ndërtimit Koncesionari duhet t'i përcjellë Autoritetit Kontraktues materialet e mëposhtme:

- (i) të gjitha të dhënat teknike (duke përfshirë raportin e projektit, oponencat, dokumentet e përlllogaritjeve dhe projektimit, si në formë të printuar, ashtu edhe në formë elektronike, duke përfshirë të gjitha udhëzimet e nevojshme lidhur me rrjetin dhe sistemin kompjuterik) që lidhen me këtë Koncesion;
- (ii) materialet teknike dhe vizatimet e pajisjeve, duke përfshirë skicat origjinale (përfshi vizatimet e ndërtimit "*siç është realizuar*"), dokumentet, udhëzimet dhe certifikatat e cilësisë, librin e evidencave të instalimeve dhe të inspektimeve;
- (iii) të gjitha dokumentet ose materialet teknike që lidhen me Koncesionin, siç mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

16.6.2 Të drejtat e Pronësisë Intelektuale

Koncesionari garanton Autoritetin Kontraktues se i ka të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale (*nëse është rasti*) përfshirë licencat e duhura që kanë të bëjnë në (hardware)dhe programet kompjuterike (software) që përdoren gjatë zbatimit të Koncesionit.

16.6.3 Të Drejta dhe Detyrime të tjera të Koncesionarit

16.6.3.1 Lejet e aplikueshme

Koncesionari, gjatë kohëzgjatjes së Periudhës së Koncesionit, duhet të zbatojë dhe të jetë në përputhje me Lejet, Autorizimet, Licencat.

16.6.3.2 Taksat dhe detyrimet

Koncesionari duhet që gjatë Periudhës së Koncesionit të paguajë në mënyrë të rregullt Tarifën Koncesionare, taksat, tatimet, detyrimet, TVSH-në, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të të punësuarve, borxhet apo tatimin mbi të ardhurat, detyrimet për taksat indirekte, detyrimet doganore, taksat e shërbimeve të cilat mund të vilen, të merren ose të përfitohen në çdo kohë nga çdo Ent apo Organ Shtetëror duke përfshirë, në zbatim të Infrastrukturës dhe Shërbimeve të Projektit sipas ligjit në fuqi.

16.6.3.3 Dëmshpërblimi

Koncesionari gjatë ekzistencës së kësaj Kontrate si dhe deri në zgjidhjen e të gjithë pretendimeve dhe kërkesave që lidhen me veprime a mosveprime gjatë ekzekutimit të kësaj Kontrate do të dëmshpërblejë apo ruajë nga dëmtimet Autoritetin Kontraktues, Entet Shtetërore që ushtrojnë funksionet si pjesë e pandashme e Koncesionit dhe punonjësit e tij/tyre, nga dhe kundër të gjitha ankesave dhe kërkesave të bëra dhe/ose humbjeve dhe/ose dëmeve të shkaktuara dhe/ose kostove, tarifave/shpenzimeve të bëra dhe/ose gjobave të vëna dhe/ose ndonjë ankese për shkak të lëndimit ose vdekjes së çdo personi dhe/ose humbjes ose dëmtimit të shkaktuar ose të pësuar nga pronat në pronësi ose që i përkasin Autoritetit Kontraktues, Enteve Shtetërore që ushtrojnë funksionet si pjesë e pandashme e Koncesionit dhe punonjësve të tij/tyre, kur këto pasoja vijnë si rezultat i punës së kryer nga Koncesionari. Kjo si rezultat i çdo akti, dokumenti ose veprimi të bërë apo lënë pa bërë nga Koncesionari ose si rezultat i dështimit nga Koncesionari për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate ose si rezultat i shkeljes nga Koncesionari të ndonjë prej parashikimeve të kësaj Kontrate ose të dështimit të Koncesionarit për të kryer ndonjë prej detyrave dhe/ose detyrimeve të tij duke përfshirë detyrat ligjore ose që rezultojnë nga ndonjë njoftim, veprim, padi apo procedurë të dhëna, të regjistruara ose të filluara nga çdo palë/person e tretë në lidhje me këtë Kontratë dhe/ose që kanë lidhje me përdorimin nga Koncesionari, të sheshit ku zbatohet Projekti apo me asetet e portit dhe/ose ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës dhe Shërbimeve të Projektit.

16.6.3.4 Cedimi apo transferimi i të drejtave dhe kompetencave

Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, Koncesionari nuk do të cedojë apo transferojë të drejtat, privilegjet ose interesat e tij sipas kësaj Kontrate në favor të ndonjë personi pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

16.7 Detyrime të tjera të Koncesionarit:

Krahas detyrimeve të tjera në Kontratë, Dokumentet e Procedurës Konkurruese, Ofertën e Koncesionarit, Koncesionari do të sigurojë:

- a. programimin e hyrjes, ankorimit dhe lundrimit të sigurt të mjeteve lundruese deri në vendin e akostimit;

- b. mbajtjen e kanalit të hyrjes në parametrat e kërkuara në Dokumentet e Procedurës Konkurruese duke siguruar lundrimin e sigurt të mjeteve lundruese duke siguruar që niveli i ujit në platformë dhe/ose ne pontile është në nivelin e duhur për të siguruar akostimin dhe qëndrimin e sigurt të mjeteve lundruese;
- c. thellësinë e duhur të hauzeve dhe përgjatë platformës së akostimit të kryejë operacione mirëmbajtje dhe kapitale, me qëllim mbajtjen në nivelet e shfrytëzimit të portit në parametrat e përcaktuar në Kontratë;
- d. Të informohen menjëherë organet shtetërore kompetente për të ndjekur penalisht çdo person për çdo vepër penale brenda portit.

16.8 Detyrime të tjera të Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues, pas Fazës Ndërtimore, por para fillimit të Fazës së Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, me kërkesë të Koncesionarit do të ndihmojë dhe asistojë në vendosjen dhe ngritjen sa më të shpejtë të shërbimit të kontrollit kufitar dhe doganor, sanitar dhe çdo shërbim tjetër në zbatim të VKM për shpalljen e portit të hapur, në përputhje me Ligjin Nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe Ligjit Nr. 9710, datë 10.04.2007 “Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, deri në mbarimin e Periudhës Koncesionare, por gjithmonë pasi Koncesionari të ketë plotësuar dhe paraqitur të gjithë dokumentacionin ligjor përkatës.

16.9 Shërbime të ndryshme (*utilities*) pikat e lidhjes

I. Autoriteti Kontraktues do ta asistojë Koncesionarin që gjatë gjithë kohëzgjatjes së Periudhës së Koncesionit t’i sigurohet nga entet përkatëse akses në infrastrukturë dhe shërbime përfshirë ujin, energjinë, dhe telekomunikimin e nevojshme për zbatimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e portit dhe asetëve të tij në përputhje me Kontratën, me kusht që Koncesionari të ketë plotësuar dokumentacionin e kërkuar ligjor. Autoriteti Kontraktues do të asistojë Koncesionarin, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore, vetëm për të siguruar pikat e lidhjes për: hyrje dalje në rrugë; furnizimin me energji elektrike; dhe furnizimi me ujë, në pikën më të afërt me Portin, me kusht që Koncesionari të ketë plotësuar dokumentacionin e kërkuar ligjor.

II. Koncesionari me shpenzimet e veta do të instalojë pajisje matëse për të matur konsumin e ujit dhe energjisë. Autoriteti Kontraktues nuk garanton cilësinë dhe sasinë e ujit dhe të energjisë dhe nuk përgjigjet për mosfurnizim apo furnizimin e mangët me këto shërbime nga entet përkatëse. Koncesionari me shpenzimet e tij, dhe nën riskun e vet dhe në përputhje me Ligjet, mund të gjejë zgjidhje alternative për furnizim me shërbimet më sipër. Sidoqoftë, Autoriteti Kontraktor nuk përjashtohet nga detyrimi i tij për dhënien e asistencës në zgjidhjen në kohë të këtij problemi.

Për shmangien e çdo paqartësie lidhja me energjinë elektrike, ujësjellës kanalizime, etj.

(*utilities*) është detyrim i Koncesionarit dhe jo i Autoritetit Kontraktues. Koncesionari, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të lidhë për këtë qëllim kontratat përkatëse me entet private që ofrojnë këto shërbime.

Neni 17 **Ndryshime në Ligj**

17.1 “Ndryshim në Ligj” do të konsiderohet secili nga rastet e mëposhtme dhe që ka Efekt të Kundërt Thelbësor:

- (i) miratimi, shpallja, modifikimi, ri-interpretimi ose shfuqizimi pas datës së kësaj Marrëveshje nga çdo autoritet qeveritar të çdo ligji, rregulli, akti nënligjor, rregulloreje ose urdhri, traktati, konvente, direktive, udhëzimi, politike që ka fuqinë e ligjit; ose
- (ii) vendosja nga çdo autoritet qeveritar i çdo kushti material (ndryshe nga një kusht i cili është vendosur si rrjedhojë e shkeljes nga Koncesionari të çdo Leje, Autorizimi, Licence) në lidhje me lëshimin, ripërtëritjen ose modifikimin e çdo Leje, Autorizimi, Licence pas datës së kësaj Marrëveshje e cila e bën kryerjen nga Koncesionari të secilit nga kushtet e kësaj marrëveshje të pamundur ose e pazbatueshme; ose
- (iii) çdo Leje, Autorizim, Licencë e dhënë më parë, dhe që nuk prodhon efekte të mëtejshme për arsye të ndryshme nga shkelja ose neglizhenca e Koncesionarit ose çdo Leje, Autorizim, licencë e dhënë për një periudhë të kufizuar dhe e ripërtëritur me kushte të tjera (më të rënda/shtrënguese) nga ato të caktuara më parë.

Me kusht që çdo:

- (a) vendosje e taksave, tatimeve, taksave lokale dhe/ose rritja e tyre herë pas here nga Autoriteti Qeveritar, dhe/ose
 - (b) vendosja e standardeve dhe kushteve të funksionimit, mirëmbajtjes dhe sigurisë që rrjedh nga legjislacioni për mjedisin, i ri ose i ndryshuar; dhe/ose
 - (c) imponimi i standardeve e kushteve të punësimit apo kushteve e punës të punëtorëve; dhe/ose
 - (d) çdo rregull ose rregullore të përcaktuara nga çdo autoritet tjetër rregullator që ka juridiksion mbi Projektin lidhur me standardet e shërbimit;
- nuk konsiderohen Ndryshim në Ligj.

17.2 Sigurimi i garancive të përshtatshme

(i) Në rastin e Ndryshimit në Ligj, Koncesionari mund t'i propozojë Autoritetit Kontraktues, dhe Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga dita e propozimit, ka të drejtë të hyjë në bisedime me Koncesionarin për të kryer ndryshime të parashikimeve të kësaj Kontrate që janë të arsyeshme dhe që kanë për qëllim të zvogëlojnë ndikimin negativ të Ndryshimit në Ligj. Në një rast të tillë Palët duhet të bien dakord për ndryshime të përshtatshme për kushtet e kësaj marrëveshje, derisa Koncesionari të vendoset në të njëjtin pozicion ligjor dhe financiar siç ishte para Ndryshimit në Ligj.

- (ii) Me të ndodhur një Ndryshim në Ligj, Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktues, për sa më poshtë:
- (a) veçoritë, natyrën dhe impaktin e ndryshimit të ligjit mbi Projektin;
 - (b) në detaje të mjaftueshme, vlerësimin e kostos shtesë nga Koncesionari për shkak të Ndryshimit në Ligj, dhe
 - (c) masat që ka marrë Koncesionari ose propozimet e tij për të zbutur impaktin e Ndryshimit në Ligj, duke përfshirë veçanërisht zvogëlimin e kostos shtesë.

Neni 18

Supervizimi i Punimeve të Ndërtimit

18.1 Supervizimi i Punimeve të Ndërtimit do të kryhet në përputhje me Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi për supervizimin e punimeve të ndërtimit. Supervizori i Pavarur do të përzgjidhet dhe përmbushë detyrat sipas kësaj Kontrate për periudhën nga Efektive deri pas 3 (tre) muajsh nga data e fillimit të Fazës së Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes. Të gjitha shpenzimet dhe kostot që kanë lidhje me Supervizorin e Pavarur do të mbulohen nga Koncesionari.

Nëse Autoriteti Kontraktues, qoftë me iniciativën e vet, qoftë mbi bazën e një raporti me shkrim nga Koncesionari ka dyshime të arsyeshme të besojë se Supervizori i Pavarur nuk po kryen detyrën e tij në përputhje me Kontratën dhe në mënyrë profesionale, pasi t’i japë Supervizorit të Pavarur mundësinë për ta dëgjuar, ka të drejtë ta pushojë atë dhe të zgjedhë një tjetër, në bazë të vendimit të një komisioni këshillimor, të përbërë nga 1 (një) anëtar i Autoritetit Kontraktor, 1 (një) anëtar i Koncesionarit dhe 1 (një) anëtar nga Unioni Shqiptar i Arkitektëve Urbanistëve dhe Planifikuesve Urban, të cilët zgjedhin me shumicë votash një Supervizor të Pavarur. Nëse secila Palë kundërshton ndonjë këshillë, udhëzim apo vendim të Supervizorit të Pavarur, mosmarrëveshja do të zgjidhet sipas nenit 26.

18.2 Lëshimi i Lejes së Shfrytëzimit/Certifikatës së Përdorimit bëhet në bazë të ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala për zbatim të tij.

- (i) Të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para përfundimit të Punimeve të Ndërtimit, Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën kur synon të fillojë Fazën e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes. Autoriteti Kontraktues do të vijojë pas këtij njoftimi me inspektimin e Punimeve të Ndërtimit me qëllim dhënien e “Lejes së Shfrytëzimit”. Ai do ta njoftojë Koncesionarin e do të përcaktojë mënyrën se si do të kryhen Testet (“Testet”), për të siguruar në këtë mënyrë që Projekti ka realizuar KTP dhe KTN dhe standardet sipas kësaj kontrate. Data dhe koha e kryerjes së çdo testi do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktues në marrëveshje me Koncesionarin. Autoriteti Kontraktues do të dërgojë

edhe përfaqësues të tij për të asistuar gjatë Testeve. Koncesionari gjatë kryerjes së testeve do t'i ofrojë Autoritetit Kontraktues të gjithë ndihmën e nevojshme për t'i realizuar ato. Në rast mosmarrëveshje lidhur me datën e kryerjes së testeve ato do të fillojnë jo më herët se 10 (dhjetë) ditë nga njoftimi i Koncesionarit;

- (ii) Pas kryerjes së çdo Testi, Autoriteti Kontraktues do të pajisë Koncesionarin me kopje të të gjitha të dhënave të testit përfshirë rezultatet analitike të tij;
- (iii) Me përfundimin e Punimeve të ndërtimit dhe pasi Autoriteti Kontraktues t'i ketë konsideruar të gjitha Testet të suksesshme do t'i lëshojë Koncesionarit Lejen e Shfrytëzimit;

Neni 19

Shfrytëzimi dhe Mirëmbajtja

19.1 Detyrimet e Koncesionarit

19.1.1 Krahas detyrimeve të tjera në këtë Kontratë, Koncesionari do të administrojë, shfrytëzojë, mirëmbajë dhe riparojë objektin e koncesionit dhe asetet krejtësisht me shpenzimet, kostot dhe nën riskun e vet në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.

Detyrimet e Koncesionarit do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen, në sa më poshtë vijon:

i. Koncesionari:

- a. Do të fillojë menjëherë veprimtarinë e shfrytëzimit pas shpalljes nga Këshilli i Ministrave port i hapur për trafik ndërkombëtar;
- b. Do të sigurojë një përdorim optimal të të gjithë objektit të koncesionit dhe aseteve në port;
- c. Do të sigurojë që Shërbimet që do të ofrohen sipas kësaj Kontrate të jenë konform standardeve të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes si dhe standardeve të sigurisë detare në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe që të ekzistojnë kushte shfrytëzimi të sigurt, funksionale dhe normale e të pandërprera të rrjedhës së trafikut rrugor dhe portual;
- d. Do të minimizojë rrjedhën e trafikut në rast aksidentesh apo incidentesh që prekin sigurinë në port duke vepruar shpejt dhe gatshëm dhe duke mbajtur lidhje me shërbimet e urgjencës të Autoritetit Kontraktues apo të Enteve të tjera;
- e. Do të ketë gati për përdorim të gjitha burimet financiare, teknike, teknologjike, administrative dhe burime të tjera për shfrytëzimin, mirëmbajtjen, riparimin dhe zëvendësimin në kohë të përshtatshme të aseteve që mund të dëmtohen;
- f. Përveç rasteve të urgjencës do të shfrytëzojë dhe administrojë Infrastrukturën dhe Shërbimet, sipas parimit “kush vjen i pari, shërbehet i pari” (*first come, first serve*) dhe atij të mosdiskriminimit.

- g. Do të sigurojë ruajtjen në mënyrën e duhur të të dhënave/ regjistrimeve/llogarive që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e portit dhe ofrimin e Shërbimeve si dhe pasqyrimin e saktë të xhiros së kryer;
- h. Do të pajiset, mbajë të vlefshme dhe zbatojë Lejet, Autorizimet, Licencat dhe do të zbatojë Ligjet, përfshirë, por pa u kufizuar, ato që kanë të bëjnë me sigurinë e pontileve, platformave, ambienteve të brendshme (ujore dhe tokësore) të portit, shëndetit, mjedisit dhe sigurisë në punë.
- i. Në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate do të kryejë, marrë përsipër apo sigurojë, në lidhje me koncesionin, të gjitha shërbimet që Autoriteti Kontraktues do të ishte i autorizuar të kryente, merrte përsipër apo siguronte sikur t'i kryente vetë këto shërbime.
- j. Do të parandalojë, me ndihmën e organeve ligj zbatuese, çdo cënim apo përdorim të paautorizuar të portit dhe asetëve të tij.
- k. Do të zbatojë me përpikmëri Rregulloren për Përdorimin dhe Menaxhimin e Portit Turistik, pasi të ketë marrë paraprakisht pëlqimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me tekstin e saj.

(ii) Riparimet dhe Mirëmbajtja

Koncesionari me shpenzimet e veta:

- a. do të riparojë dhe mirëmbajë portin dhe asetet e tij apo ndonjë pjesë të tyre dhe për këtë qëllim ndër të tjera do të marrë masa ruajtje dhe parandaluese;
- b. do të mirëmbajë portin dhe asetet e tij në përputhje me Ligjet, parashikimet e kësaj Kontrate dhe me Praktikat e Mira të Industrisë me qëllimin për të ofruar standarde shërbimi të përshtatshme dhe për të siguruar që porti dhe asetet të transferohen tek Autoriteti Kontraktues me mbarimin e Periudhës së Koncesionit në gjendje të mirë, përjashtuar amortizimin normal.

(iii) Aksesi për inspektime

Koncesionari është i detyruar t'i ofrojë të gjithë bashkëpunimin ekspertëve të caktuar nga Autoriteti Kontraktues për të verifikuar që porti dhe asetet e tij janë duke u shfrytëzuar dhe mirëmbajtur në përputhje me Ligjet, këtë kontratë dhe Praktikat e Mira të Industrisë. Inspektime të tilla do të kryhen çdo vit, pas njoftimit paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

(iv) Raportimi

Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues raporte mujore dhe përmbledhëse vjetore lidhur me trafikun e mjeteve lundruese dhe tarifrat e vjela. Koncesionari duhet të paraqesë raport vjetor të detajuar mbi kostot e sistemit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të Portit.

(v) Sistemi dhe Rrjeti Kompjuterik

Koncesionari do të instalojë, përdorë, mirëmbajë sistemin dhe rrjetin kompjuterik (*përfshirë Sistemin e Shkëmbimit të të Dhënave dhe Sistemin e Komunikimit me Kapitenerinë dhe organet kompetente*) duke ndjekur të gjitha protokollet që Autoriteti Kontraktues do të përcaktojë kohë pas kohe.

(vi) Çështjet e Sigurisë

Koncesionari lidhur me çështjet e sigurisë në porte do të zbatojë me përpikmëri kërkesat e ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013 “Për sigurinë në anije dhe në porte”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

(vii) Punësimi i Personelit

Koncesionari do të punësojë personel të kualifikuar dhe të aftë në funksion të realizimit të objektit të Kontratës. Kushtet e punësimit mund të përcaktohet sipas nevojave të tij nga Koncesionari, por do të jenë në përputhje me Ligjet dhe Koncesionari do të mbajë çdo përgjegjësi në këtë drejtim. I gjithë dokumentacioni që kërkohet lidhur me punësimin e personelit të huaj do të plotësohet dhe përgatitet para punësimit apo kontraktimit të këtij personeli. Për shmangien e çdo paqartësie dështimi për përgatitje të kësaj dokumentacioni në përputhje me Ligjet nuk do të përbëjë Forcë Madhore. Të gjithë të punësuarit janë përgjegjësi e Koncesionarit.

(viii) Dëmshpërblim ndaj pretendimeve për dëmtime

Koncesionari do të jetë përgjegjës ndaj të gjitha dëmtimeve që mund t’u shkaktohen të tretëve si rezultat i veprimeve të tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes sipas kësaj Kontrate.

(ix) Infrastruktura për kapitenerinë, doganën dhe policinë

Dogana e portit dhe shërbimet policore janë nën kontrollin e qeverisë. Koncesionari do të ndërtojë infrastrukturën e nevojshme për organet e kapitenerisë, policisë kufitare, doganës dhe institucioneve të tjera të nevojshme sipas projektit të miratuar nga organi administrativ fundor vendimmarrës.

Neni 20

Objektet Arkeologjike ose objektet e Trashëgimisë Kulturore

Zbulimi i relikave kulturore, arkeologjike, fosile, turma varrezash dhe përmendore, mbetje të kaluara artistike dhe çdo send tjetër me vlerë arkeologjike, gjeologjike dhe historike në vendndodhjen e Sheshit që rezulton në ndërhyrjen e punimeve të koncesionarit do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Koncesionari duhet të njoftojë

autoritetin kontraktor për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e njësisë së zbatimit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 21

Forca Madhore

21.1 “Rast i Forcës Madhore” do të thotë çdo rrethanë apo ngjarje që në mënyrë objektive është tej parashikimit dhe kontrollit absolut, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të Palës së Cënuar (“**Pala e Cënuar**”) shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të Palës së Cënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

21.1.1 kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohej apo nuk ishte e mundur të parandalohej, shmangej ose mënjanohet nga Pala e Cënuar;

21.1.2 Pala e Cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;

21.1.3 ngjarja nuk është, ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, dhe

21.1.4 Pala e Cënuar t’i ketë dhënë njoftim Palës tjetër (“**Pala e Pacënuar**”).

21.2 Rastet e Forcës Madhore përfshijnë rrethanat e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to, me kusht që ato të plotësojnë kriteret e shprehura në përkufizimin e Rastit të Forcës Madhore më sipër:

21.2.1 veprimet e luftës, pushtimi ose akti i një armiku të jashtëm, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;

21.2.2 aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizimit;

21.2.3 rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;

21.2.4 epidemitë, pandemite ose murtaja; dhe

21.2.5 çdo akt sabotimi, grevat ose veprimtaritë e punës për të imponuar ose për të ngadalësuar punën (*sidoqoftë duke përjashtuar punonjësit e palës që pretendon atë si rast të forcës madhore, ose punonjësit e ndonjërit prej ortakëve/aksionarëve të kësaj pale, ose punonjësit e ndonjë filiali të kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi nga shoqëria mëmë ose degë e ndonjë ortaku/aksionari të kësaj pale*).

Pala e Cënuar do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve dhe nuk do të konsiderohet në mospërmbushje të Kontratës për aq kohë dhe në atë masë sa zgjat pamundësia për të përmbushur detyrimet. Njëkohësisht, Periudha e Koncesionit do të shtyhet automatikisht për aq

sa do të zgjasë Ngjarja e Forcës Madhore.

21.2.6 Pavarësisht nga detyrimet për mirëmbajtje të Koncesionarit, në masën që Koncesionari është Palë e Cënuar në një Rast apo Ngjarje të Forcës Madhore, raste që rezultojnë të siguruara në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe pasojat e këtij Rasti apo Ngjarje të Forcës Madhore janë brenda kushteve që mbulohen nga garancitë siguruese që kërkohet të bëhet në përputhje me ligjin nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, Koncesionari do të ngrejë pretendime e do t'i bazojë ato drejtpërdrejt tek Sigurimet sipas nenit 10 duke zbatuar parashikimet përkatëse të këtij neni dhe legjislacionit zbatues në fuqi.

Neni 22

Rastet e Mospërmbushjes

22.1 Rasti i Mospërmbushjes nga Koncesionari

Secili prej rasteve të mëposhtme do të përbëjë një “**Rast Mospërmbushjeje nga Koncesionari**”, konstatuar nga vendimi i komisionit NJ.Z.P të ngritur nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo strukturë e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për këtë qëllim:

- 22.1.1 mospërmbushja nga Koncesionari, në mënyrë thelbësore, i KTP dhe KTN si dhe i ofrimit të Shërbimit;
- 22.1.2 braktisja e Punimeve sipas nenit 16.5 ose ofrimit të Shërbimeve nga Koncesionari sipas kësaj Kontrate;
- 22.1.3 mospagimi nga Koncesionari i Dëmeve brenda periudhave kohore të specifikuara këtu apo moskryerja në afat e çdo lloj pagese a dëmshpërblimi tjetër sipas kësaj Kontrate;
- 22.1.4 vonesa për pagimin e Tarifës Koncesionare për 6 (gjashtë) muaj të njëpasnjëshëm.
- 22.1.5 dështimi i Koncesionarit për të përmbushur ose heqja dorë nga çdo detyrim i tij të përcaktuar në Kontratë tjetër apo nën-kontrata, të cilat kanë dëmtuar ose mund të dëmtojnë Projektin/Infrastrukturën dhe Shërbimet e Projektit në mënyrë serioze dhe të pakthyeshme;
- 22.1.6 mos përmbushje e Rregullores së Përdorimit dhe Menaxhimit të portit turistik, e cila ka ndikuar ose mund të ndikojë në Projekt/Infrastrukturën dhe Shërbimet e Projektit në mënyrë serioze dhe të pakthyeshme;
- 22.1.7 ndonjë deklaram dhe/ ose garanci e dhënë nga Koncesionari që sipas kësaj Kontrate do të konsiderohet apo shpallet e pavlefshme me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- 22.1.8 falimentimi apo paaftësia paguese e Koncesionarit;
- 22.1.9 Sigurimi i Kontratës është në kundërshtim me këtë Kontratë apo i pavlefshëm;
- 22.1.10 Koncesionari shpreh qëllimin për të revokuar/përfunduar këtë kontratë pa pasur të drejtën për ta bërë një gjë të tillë siç është parashikuar shprehimisht në kontratës;
- 22.1.11 Shkelje tjetër e kësaj Kontrate, që për nga natyra dhe pasojat e saj është thelbësore, pavarësisht nëse është përcaktuar ose jo shprehimisht si e tillë në këtë Kontratë

konstatuar nga Autoriteti Kontraktor duke përjashtuar forcën madhore.

22.1.12 Shkelje e legjislacionit të zbatueshëm.

22.2 Rasti i Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktues

Secili prej rasteve të mëposhtme do të përbëjë një **“Rast Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktues”**:

22.2.1 Mosdhënia në afat të Lejeve, Licencave, Autorizimeve ose kryerja apo moskryerja e një veprimi në kompetencë të tij që cenon veprimtarinë e Koncesionarit nga Autoriteti Kontraktues, pas plotësimit të dokumentacionit të plotë dhe brenda afatit nga Koncesionari.

22.2.2 Çdo shkelje e kësaj Kontrate, që për nga natyra dhe pasojat e saj është thelbësore, pavarësisht nëse është përcaktuar ose jo shprehimisht si e tillë në të, përjashtuar Forca Madhore.

22.3 Njoftimi për Bisedime

Secila prej palëve duke ushtruar të drejtën që i jep ky nen-do t’i dërgojë Palës tjetër një njoftim me shkrim duke i shpjeguar me hollësi shkakun e mospërmbushjes dhe do t’i propozojë bisedime mes Palëve për të gjetur mundësitë e kapërcimit të këtij shkakun “Njoftimi për bisedime”

22.4 Ndreqja e rasteve të mospërmbushjes

Me të marrë njoftimin për bisedime, secila nga palët, brenda një afati jo më të gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë “Periudha e Bisedimeve”, ose për sa kohë palët kanë rënë dakord, Palët do të ulen në bisedime për të arritur një marrëveshje të shkruar me qëllim të zgjidhjes së rastin e mospërmbushjes. Përjashtimisht, në rast marrjeje dijeni për kryerje Aktë Korruptive të Koncesionarit, secila palë ka të drejtë të fillojë procedurat për zgjidhjen e kontratës.

22.5 Detyrimet gjatë Periudhës së Ndreqjes

Me arritjen e marrëveshjes Pala në mospërmbushje do të kryejë të gjitha veprimet e rena dakord për përmbushjen e Kontratës brenda një afati“Periudha e Ndreqjes”.

Gjatë Periudhës së Ndreqjes, Palët do të vazhdojnë të përmbushin detyrimet e tyre respektive sipas kësaj Kontrate, dhe për çdo mospërmbushje, Pala që gjendet në mospërmbushje do të kompensojë Palën tjetër për dëmet apo humbjet eventuale.

22.6 Të drejtat e Palëve

22.6.1 Pas shfaqjes së mospërmbushjes nga ana e Koncesionarit, dhe në rast mosndreqjeje të mospërmbushjes sipas nenit 22.4, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të fillojë procedurat për zgjidhjen e kontratës sipas përcaktimeve të saj.

22.6.2 Pas shfaqjes së mospërmbushjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, dhe në rast mosndreqje të mospërmbushjes sipas nenit 22.4, Koncesionari ka të drejtë të fillojë procedurat për zgjidhjen e kontratës sipas përcaktimeve të saj.

22.6.3 Secila Palë para se të procedojë me zgjidhjen e Kontratës, do të marrë në konsideratë natyrën e shkakut të mospërmbushjes, pasojat që do të ketë kjo në performancën e secilës Palë dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur mospërmbushja.

22.7 Pasojat e mospërmbushjes

Nëse edhe me kalimin e Periudhës së Ndrejjes, shkakun nuk është eliminuar ose zgjidhur, as nuk është arritur një marrëveshje gjatë fazës së bisedimeve, faktuar në mënyrë të shkruar, Pala që ka dërguar njoftimin e ndrejjes mund të njoftojë zgjidhjen e kontratës me anë të një njoftimi drejtuar palës tjetër.

Kundër njoftimit të palës për zgjidhjen e kontratës, pala tjetër ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës sipas juridiksionit të përcaktuar në këtë kontratë brenda afateve ligjore 45 ditore, sipas legjislacionit në fuqi.

22.8 E drejta e Autoritetit Kontraktues për të zëvendësuar Koncesionarin

Pasi Autoriteti Kontraktues të ketë kryer të gjitha procedurat e konstatimit të mospërmbushjes sipas parashikimeve në këtë nen, si edhe pasi t'i ketë dërguar Koncesionarit njoftimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës sipas përcaktimeve të saj, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të:

22.8.1 të marrë në dorëzim dhe të vendosë kontrollin e tij mbi Infrastrukturën dhe Shërbimet e Projektit;

22.8.2 të ndalojë Koncesionarin dhe çdo person tjetër që ka pretendime të rrjedhura nga Koncesioni të hyjë brenda Sheshit dhe të përdorë Infrastrukturën dhe Shërbimet e Projektit;

22.8.3 të zëvendësojë Koncesionarin dhe të vazhdojë punimet nëse do të jetë rasti apo të vazhdojë ofrimin e shërbimeve të Koncesionit sipas gjykimit dhe vullnetit të tij të lirë si ta vlerësojë të përshtatshme me synim arritjen e qëllimit të Koncesionit. Në rrethana të tilla Autoriteti Kontraktues merr përsipër edhe përgjegjësitë e Koncesionarit sipas kësaj Kontrate.

22.8.4 E drejta e Autoritetit Kontraktues sipas këtij neni mund të ushtrohet vetëm pasi Financuesi të mos ketë ushtruar të drejtën e tij apo në rast ndërhyrje kjo e fundit të mos ketë dhënë rezultat brenda 3 (tre) muaj për vazhdimësinë normale të Koncesionit.

22.9 E drejta e Financuesit për të ndërhyrë dhe për të zëvendësuar Koncesionarin

22.9.1 Menjëherë me marrjen dijeni për mospërmbushje nga ana e Koncesionarit për raste të parashikuara në pikat 22.1.1, 22.1.2, 22.1.5, 22.1.6, 22.1.7, 22.1.8, 22.1.9, 22.1.10, të këtij neni, Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të Periudhës së Bisedimeve

të cilat nuk përfundojnë me zgjidhje dhe para zgjidhjes eventuale të Kontratës njofton edhe Financuesin me qëllim që t'i japë mundësi këtij të fundit të ndihmojë Koncesionarin për të korrigjuar dhe për të marrë masa për të rregulluar mospërmbushjet brendaditësh nga një njoftim i tillë.

22.9.2 Në rast se nuk është i mundur korrigjimi i mospërmbushjes nga Koncesionari, Financuesi nëse e vlerëson në interes të tij mund të ndërhyjë në këtë Koncesion duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e koncesionit në duart e një ekipi drejtues zëvendësues ose një subjekti zëvendësues në përputhje me piken 22.8.3, i cili duhet të ketë ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Koncesionarit në momentin e shpalljes fitues i Koncesionit. Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë pa arsye dhënien e pëlqimit për këtë zëvendësim. Zëvendësuesi do të ketë të gjitha të drejtat sipas këtij Koncesioni dhe do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin prej tij, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, transferojë dhe vendosë barrë siguroese mbi inventarët dhe të ardhurat e Koncesionit.

Nëse Financuesi zgjedh të mos ndërhyjë në Koncesion ose nëse brendamuajve nga ndërhyrja nuk arrihet një zgjidhje e arsyeshme për vazhdimësinë e Koncesionit Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën sipas parashikimeve të saj.

Në rast se ka kosto financiare për ndërhyrjen nga Financuesi, ky i fundit i ka marrë parasysht vetë dhe është i gatshëm për ti përmbushur këto kosto financiare.

22.10 Mospërmbushjet e Kontratës dhe shpërblimi i dëmit.

22.10.1 Përgjegjësitë

Mospërmbushjet e Kontratës dhe shpërblimi i dëmit

22.10.1.1 Përgjegjësitë

Secila Palë është përgjegjëse të dëmshpërblejë Palën tjetër për dëme që vijnë si rezultat i mospërmbushjes së garancive dhe detyrimeve të parashikuara në Kontratë. Ky parashikim nuk zbatohet në rastin e Forcës Madhore. Në këtë rast secila Palë përballon kostot dhe shpenzimet e veta të kryera deri në momentin e ndodhjes së rastit të Forcës Madhore.

22.10.1.2 Penalitetet

Ndaj çdo Pale që është në mospërmbushje, aplikohen penalitet sipas përcaktimeve në këtë kontratë në kuptim të dispozitave të Kodit Civil të R.SH-se.

22.10.1.3 Njoftimet

Në rast pretendimi për mospërmbushje, Pala në përmbushje të Kontratës duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Palën në mospërmbushje.

22.10.1.4 Vonesa në korrigjimin e gabimeve

Secila Palë duhet të bëjë përpjekje për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve dhe ndreqjen e mospërmbushjes. Në çdo rast, Pala në mospërmbushje do të ketë në

dispozicion ditë për ndreqjen e mospërmbushjes. Përjashtimisht, në rast marrje dijeni për kryerje Akte Korruptive të Koncesionarit, secila palë ka të drejtë të fillojë procedurat për zgjidhjen e kontratës.

22.10.1.5 Dështimi i Palës në mospërmbushje për të ndrequr situatën

Dështimi i Palës në mospërmbushje për të ndrequr situatën brendaditëve do t'i japë Palës në përmbushje të drejtën të fillojë procedurat për zgjidhjen e kontratës kundrejt një njoftimi me shkrim.

22.10.1.6 Vazhdimësia

Gjatë periudhës ditore secila Palë do të përmbushë Kontratën në mirëbesim dhe në mënyrë të rregullt, në të kundërt detyrohet të shpërblejë dëmin që i shkaktohet Palës tjetër.

Neni 23

Zgjidhja e Kontratës

23.1 Procedurat e zgjidhjes

Palët me vullnet të dyanshëm të shprehur, me anë të një kërkesë të njërës palë dhe miratim të palës tjetër mund të zgjidhin para afatit 35 vjeçar këtë kontratë. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, autoriteti kontraktues mund të ndërpresë kontratën kur:

- a) mund të provojë se Koncesionari nuk mund të kryejë detyrimet e veta, për shkak të paaftësisë paguese dhe shkeljeve serioze, të konsideruara të tilla nga legjislacioni në fuqi, që pengojnë apo nuk lejojnë vazhdimin e kontratës, në përputhje me standardet teknike dhe me standardet e tjera të pranuar;
- b) Koncesionari/partneri privat dështon në sigurimin e financimit të projektit brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi e kontratës, sipas mënyrave të parashikuara në këtë kontratë dhe dokumentet e tenderit.
- c) SPV transferon aksionet/kuotat e veta tek të tretët, pa miratim të Autoritetit Kontraktues, përveçse nëse ky transferim është një rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit.

2. Secila palë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

- a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave të secilës palë;
- b) ka shkelje serioze nga pala tjetër dhe se kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

3. Palët kanë, gjithashtu, të drejtë të zgjidhin kontratën me pëlqimin reciprok.

4. Para zgjidhjes së kontratës, në përputhje me këtë nen, autoriteti kontraktues informon Ministrinë e Financave për të gjitha rrethanat e njohura, të cilat çojnë dhe krijojnë kushtet për zgjidhjen e

kontratës dhe kërkon mendimin e saj.

23.1.1 Zgjidhja e kontratës si pasojë e Forcës Madhore

Në rast zgjidhje të Kontratës për shkak të Forcës Madhore gjatë periudhës së ndërtimit secila Palë mbart shpenzimet e veta të kryera deri në momentin kur filloi ngjarja e Forcës Madhore.

Në rast të zgjidhjes së Kontratës për shkak të Forcës Madhore gjatë periudhës së shfrytëzimit Autoriteti Kontraktues do të marrë në dorëzim investimet e kryera deri në atë moment dhe Objektin e Koncesionit në gjendjen “*siç do të jetë*” pa asnjë barrë, sipas parashikimeve të nenit 23, për aq sa mund të aplikohen duke i paguar Koncesionarit një shumë të barabartë me vlerën e investimit sipas faturave dhe në përputhje me ofertën, minus të ardhurat e përfituara nga Koncesionari nga çdo lloj siguracioni dhe normës normale të amortizimit të asetëve.

23.1.2. Zgjidhja e Kontratës për mospërmbushje nga Koncesionari

Në rast zgjidhje të kontratës në përputhje me parashikimet e saj për mospërmbushje nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës, sipas juridiksionit të zgjedhur nga palët në këtë kontrate, për përcaktimin e shumës së dëmshpërblimit apo kompensimit që i takon.

23.1.3 Zgjidhja e Kontratës për mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktues

Në rast zgjidhje të kontratës në përputhje me parashikimet e saj, për mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktues, Koncesionari ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës sipas juridiksionit të zgjedhur nga palët në këtë kontratë, për përcaktimin e shumës së dëmshpërblimit, kompensimit dhe fitimit të munguar që i takon.

23.2 Detyrime të tjera

Gjatë procedurës për zgjidhjen e kontratës dhe deri në një vendim të gjykatës së formës së prerë, nëse është marrë një vendim për sigurim padie, Palët do të vazhdojnë të përmbushin detyrimet e tyre respektive, për aq sa këto detyrime mund të përmbushen, me qëllim për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara për përdoruesit/klientët. Pala që nuk do të mund të përmbushë këto detyrime, duke sjell pasojë negative tek përdoruesit/klientët, do të kompensojë Palën tjetër për çdo dëm apo humbje të shkaktuar.

Asnjëra palë nuk ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe në kundërshtim me mënyrën dhe procedurën e parashikuar në këtë kontratë.

Gjatë procedurës për zgjidhjen e kontratës veprimtaria e portit do të vazhdojë normalisht deri në dorëzimin e portit, siç parashikohet në këtë kontratë.

23.3 Pasoja e përfundimit

Në përputhje me përcaktimet e kësaj Kontrate:

- (i) Koncesionari do të transferojë të gjitha asetet (sipas përkufizimit në nenin 1.1.) dhe të drejtat me përfundimin e Koncesionit si rezultat i mbarimit të Periudhës Koncesionare, apo i zgjidhjes së Kontratës;
- (ii) Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë arkëtojë çdo garanci bankare të lëshuar nga Koncesionari për çdo shumë që Koncesionari është debitor ndaj Autoritetit Kontraktues.
- (iii) Çdo policë sigurimi do të kalojë në emër të Autoritetit Kontraktues, i cili do të jetë i vetmi përfitues prej tyre nëse do të jetë rasti;

23.4 Pasoja e zgjidhjes dhe detyrime të Koncesionarit

Në rast zgjidhje të Kontratës:

- (i) Koncesionari do të transferojë tek Autoriteti Kontraktues pa asnjë barrë, të gjitha pasuritë e paluajtshme, asetet (sipas përkufizimit në nenin 1.1.), pajisjet, makineritë dhe të drejtat Koncesionare dhe të pronësisë intelektuale (*nëse ka*);
- (ii) Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të arkëtojë çdo garanci bankare të lëshuar nga Koncesionari për shumën që Koncesionari është debitor ndaj Autoritetit Kontraktues.
- (iii) Çdo policë sigurimi do të kalojë në emër të Autoritetit Kontraktues, i cili do të jetë i vetmi përfitues prej tyre.

23.5 Pasoja e zgjidhjes së Kontratës për mospërbushje me faj të Autoritetit Kontraktues

Në rast zgjidhjeje të Kontratës në përputhje me parashikimet e saj, në rast të mospërbushjeve nga Autoriteti Kontraktues, Koncesionari ka të drejtë për shpërblimin e dëmit si më poshtë, përveç nëse kjo Kontratë parashikon ndryshe:

23.5.1 Në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë periudhës nga Data Efektive deri në përfundim të Fazës Ndërtimore të dëmshpërblehet për vlerën e ndërtimit të kryer efektivisht plus 0,2 % të Vlerës së Investimit, por gjithsesi jo më shumë se Vlera e Investimit sipas kësaj kontrate dhe nëse koncesionari nuk është dakord me këtë dëmshpërblim, ka të drejtë ti drejtohet Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë;

23.5.2. në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të parë deri në vitin e tretë të operimit (viti i tretë i përfshirë) me vlerën e ndërtimit të kryer efektivisht plus 0,5 % të Vlerës së Investimit, por gjithsesi jo më shumë se Vlera e Investimit sipas kësaj kontrate;

23.5.3. Nga viti i katërt i operimit deri në vitin e gjashtë (viti i gjashtë i përfshirë) me vlerën e ndërtimit të kryer efektivisht minus amortizimin normal, plus fitimin mesatar të tre viteve paraardhëse të aktivitetit.

23.5.4. Nga viti i shtatë i shfrytëzimit e më tej me vlerën e ndërtimit të kryer efektivisht minus amortizimin normal, plus fitimin e munguar deri në fund të periudhës koncensionare.

23.5.5. Vlera e ndërtimit dhe çdo investimi tjetër të kryer deri në ato momente nga Koncesionari, do të përcaktohet nga një komision ekspertësh të pasurive të paluajtshme, i përberë prej tre anëtarësh, një nga secila palë dhe i treti i zgjedhur nga dy anëtarët e zgjedhur nga Palët. Komisioni paraqet akt-vlerësimin pasi të ketë rënë dakord me unanimitet për të gjithë përmbajtjen e tij.

23.5.6. Me pagesën e dëmshpërblimeve si më sipër të gjitha Asetet (sipas përkufizimit në nenin 1.1.) e çdo lloji të kryera deri në momentin e zgjidhjes së Kontratës, kalojnë në pronësi të Autoritetit Kontraktues.

23.6 Pasoja të zgjidhjes së Kontratës për mospërmbushje të Koncesionarit

Në rast zgjidhjeje të Kontratës në përputhje me parashikimet e saj, për mospërmbushje nga Koncesionari, atëherë Autoriteti Kontraktues bëhet pronar i të gjitha asetëve të Portit, për fshirë të drejtat e pronësisë intelektuale (*nëse ka*) dhe çdo dokumentacion (*ligjor, teknik, financiar, etj.*) si dhe ka të drejtë të mbajë Garancinë e Kontratës në shumën që ajo ka në momentin e zgjidhjes së Kontratës.

Në çdo rast, përveç sa më sipër, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë në rrugë gjyqësore shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i mospërmbushjes nga ana e Koncesionarit konform dispozitave të KC në R.SH-së.

23.7 Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari nuk kanë të drejtë të kërkojnë penaltete apo dëmshpërblime të tjera në rast zgjidhjeje të Kontratës, të ndryshme nga sa parashikohet në të.

Neni 24

Transferimi në përfundim të Koncesionit

24.1 Fillimi i Transferimit

Në 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit të Periudhës Koncensionare, Koncesionari do të fillojë përmbushjen e detyrimeve të dorëzimit, siç jepen më poshtë, do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktues dhe do t'i sigurojë këtij (ose ndonjë palë të tretë të caktuar nëpërmjet saj) të gjithë aksesin dhe informacionin, siç mund të kërkohet ose është e nevojshme për të marrë në ngarkim shfrytëzimin e portit si dhe të çdo Pajisjeje Elektromekanike dhe Kompjuterike që i shërbejnë funksionimit normal të portit. Brenda një periudhe kohe të arsyeshme para mbarimit të Periudhës së Koncesionit, Palët do të takohen periodikisht me qëllim që të bien dakord për procedurat e detajuara të dorëzimit, duke përfshirë zërat e caktuar më poshtë.

a) Menjëherë pas mbarimi të Afatit:

i) Porti duhet të jetë në një gjendje të arsyeshme mirëmbajtjeje, pastërtie dhe pamjeje, duke marrë parasysh vjetërsinë dhe amortizimin e arsyeshëm, dhe brenda parametrave teknike për një funksionim normal në përputhje me destinacionin e tij;

ii) Të Drejtat Koncesionare do të mbarojnë automatikisht dhe pronësia e portit dhe e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike do t'i transferohet Autoritet Kontraktues, dhe Koncesionari nuk do të ketë më të drejta t'i përdorë dhe gëzojë ato;

iii) Të gjithë kostot, pa asnjë përjashtim, në lidhje me mbarimin automatik të të Drejtave Koncesionare, me transferimin e pronësisë së portit, Pajisjeve Elektromekanike dhe kompjuterike dhe me dorëzimin e tyre siç përcaktohet më sipër, do t'i ngarkohen dhe do të përballohen vetëm nga Koncesionari;

iv) Kontratat e licencës për përdorimin e programeve kompjuterike (software) të jenë të vlefshme për të paktën 3 muaj pas përfundimit të periudhës Koncesionare dhe të lejojnë përdorimin e tyre nga Autoriteti Kontraktues. Në çdo rast Koncesionari garanton Autoritetin Kontraktues se do të ketë akses të qetë në bazën e të dhënave të mjeteve lundruese.

v) Koncesionari do t'i transferojë menjëherë Autoritetit Kontraktues, në masën që ende nuk është transferuar, në çdo rast së bashku me detyrimet përkatëse të lindura gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit duke filluar që nga data e dorëzimit, të gjitha të Drejtat Koncesionare, titujt dhe interesat për portin si dhe Pajisjet Elektrike dhe Kompjuterike dhe gjithçka që përfshihet në to, të lira nga çdo detyrim apo barrë, duke përfshirë:

1. të gjitha lëndët e para, pjesët e konsumueshme dhe pjesët e këmbimit,

2. të gjithë pronën e trupëzuar;

3. të drejtat e pronësisë intelektuale që mbaheshin nga Koncesionari ose Shoqëria Koncesionare (ato që burojnë nga pronësia, nga ndonjë licencë ose nga ndonjë burim tjetër), në masën që këto kërkohen në mënyrë të arsyeshme për shfrytëzimin e portit dhe e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike;

4. të gjitha ndërtimet dhe pjesët e lidhura pazgjidhmërisht me to;

5. librat apo dokumentet e evidencave (records) të kompjuterizuara ose jo, raportet, të dhënat, dosjet dhe informacioni, vizatimet, rezultatet e testeve, dokumentet,

6. të gjitha garancitë e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike, materialeve dhe punimeve,

7. të gjitha të drejtat kontraktore, duke përfshirë qiratë dhe policat e sigurimit,

8. të gjitha punimet në proces (duke përfshirë Punimet e Ndërtimit, nëse ka) në bazë të kontratave me shitës, furnizues, kontraktorë dhe nënkontraktorë,

9. kontratat e licencës për përdorimin e programeve kompjuterike, të cilat duhet të parashikojnë zëvendësimin e Koncesionarit nga Autoriteti Kontraktues, në masën që këto kërkohen në mënyrë të arsyeshme për shfrytëzimin e portit dhe e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike; dhe

10. të gjitha të drejtat në lidhje me çdo shumë sigurimi për t'u paguar në emër dhe për llogari të Koncesionarit, por e papaguar në datën e zgjidhjes së kësaj Kontrate, në lidhje me të drejtat, titujt dhe interesat e Koncesionarit në Projektin Koncesionar;

vi) Kontratat e punës mes punëmarrësve dhe Shoqërisë Koncesionare do të jenë për një periudhë kohe me afat prej jo më shumë se tre muaj pas përfundimit të periudhës Koncesionare. Koncesionari njihet detyrimin t'i bëjë të ditur çdo punëmarrësi këtë fakt në kontratën individuale të punës.

vii) Koncesionari do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të zbatuar çdo transferim të parashikuar në këtë Nen, duke përfshirë nënshkrimin e çdo dokumenti të kërkuar, si dhe lidhjen me Autoritetin Kontraktues të çdo akti, kontrate ose marrëveshjeje të nevojshme dhe pa asnjë kosto ose shpenzim për Autoritetin Kontraktues (përveçse rastit siç parashikohet shprehimisht në nën paragrafin më poshtë); dhe

viii) Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për pajisjen ose dhënien, me shpenzimet e tij, të të gjitha Autorizimeve për të shfrytëzuar portin dhe Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike (ose për të transferuar shfrytëzimin e tyre tek një palë e tretë), si dhe Koncesionari do të ndihmojë Autoritetin Kontraktues për identifikimin dhe marrjen e çdo Autorizimi të tillë, duke përfshirë dhënien e ndihmës së arsyeshme në përgatitjen e kërkesave në lidhje me to.

b) Në rast zgjidhje para Afatit të kësaj Kontrate, kërkesat e pikës (a) të këtij Neni do të zbatohen *mutatis mutandis* edhe për këto raste.

Autoriteti Kontraktues bie dakord dhe merr përsipër që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga transferimi i të drejtave dhe titujve në lidhje me asetet dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse siç është parashikuar në paragrafët me lart, ai do të lëshojë Certifikatën e Pranimit të Dorëzimit të objektit të kësaj Kontrate. Koncesionari duhet të dorëzojë këto asete në gjendje funksionale. Ndërsa të gjitha asetet e sipërpërmendura të Shoqërisë Koncesionare do të transferohen të lira nga çdo detyrim apo barrë tek Autoriteti në ditën e përfundimit të Periudhës Koncesionare, vetë Shoqëria Koncesionare si dhe Koncesionari me asetet e tij nuk do të transferohen tek Autoriteti Kontraktues.

24.2 Rakordimi i detyrimeve të ndërsjella në rast të përfundimit të Periudhës së Koncesionit

Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues në fund të periudhës koncesionare do të ulen në bisedime sipas përcaktimeve të kësaj kontrate për bisedime dypalëshe mbi rakordimin e detyrimeve të ndërsjella mes palëve.

24.3 Vonesa në transferim

Në rast se transferimi i aseteve nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues është vonuar për arsye që i atribuohen Autoritetit Kontraktues, Koncesionari do të vazhdojë të shfrytëzojë portin dhe asetet sikur Kontrata të ishte në ekzekutim e sipër duke kryer karshi Autoritetit Kontraktues të gjitha pagesat sipas kësaj kontrate “Çështje Financiare”. Për shmangien e çdo paqartësie, Koncesionari në këtë rast ka të drejtë të realizojë fitime sikur Kontrata të ishte në fuqi. Ky parashikim nuk autorizon Autoritetin Kontraktues që në mënyrë të heshtur të zgjasë Periudhën e Koncesionit dhe as nuk i jep të drejtë Koncesionarit të pretendojë zgjatje në mënyrë të heshtur të afatit të Kontratës.

24.4 Risku

Deri në transferimin e plotë në përputhje me këtë nen, risku do të jetë tërësisht tek Koncesionari, përveç transferimit të vonuar për shkaqe që i atribuohen Autoritetit Kontraktues,

rast në të cilin risku do t'i kalojë këtij të fundit nga data e përfundimit të Periudhës Koncesionare.

Neni 25

Mjetet e ndreqjes, penaltete dhe dëmshpërblime

25.1 Ushtrimi i të drejtave nga secila Palë për të zgjidhur Kontratën, siç parashikohet në të, nuk do ta pengojnë atë Palë të kërkojë ndonjë të drejtë tjetër, mjet ndreqjeje apo dëmshpërblim që mund të ekzistojë sipas Ligjeve.

25.2 Të gjitha mjetet e riparimit apo dëmshpërblimit në dispozicion të Palëve do të jenë kumulative dhe mos kërkitimi apo mospërfitimi nga ndonjëri prej mjeteve të riparimit/dëmshpërblimit nga secila Palë nuk do të konsiderohet si heqje dorë:

25.2.1 nga penaltetet apo dëmet tashmë të kërkueshme;

25.2.2 nga mjetet e tjera të ndreqjes apo dëmshpërblimit.

25.3 Përveç penalteteve të tjera të parashikuara shprehimisht në Kontratë, për çdo mospërmbushje tjetër që nuk sjell si pasojë zgjidhjen e Kontratës, Koncesionari detyrohet të paguajë një penaltet për çdo ditë në mospërmbushje në shumën 10.000 lekë, por gjithsesi jo më shumë se 6 (gjashhtë) muaj. Pas kësaj periudhe Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të fillojë procedurat për zgjidhjen e kontratës.

Neni 26

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

26.1. Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjet e aplikueshme në Republikën e Shqipërisë.

26.2. Çdo mosmarrëveshje mes Palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e Kontratës, duke përfshirë, por jo vetëm, çështjet që kanë të bëjnë me përfundimin e saj, mospërmbushjet, zgjidhjen, pavlefshmërinë qofshin këto të përfshirë në Kontratë apo në Dokumentet Standarde të koncesionit dhe/ose Ofertën e Koncesionarit do të kalohen për zgjidhje me pajtim.

26.3. Vendimi në formë të shkruar i përbashkët i Palëve apo i përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht për zgjidhjen e çështjes me pajtim, do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për to.

26.4. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese, që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, duke u bazuar në vullnetin e mirë.

26.5. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet në pajtim, palët bien dakord që mosmarrëveshja të zgjidhet përfundimisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë.....

Neni 27

Dispozita të fundit

27.1 Veçimi

Nëse cilado nga dispozitat/nenet e kësaj Kontrate vlerësohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme për çfarëdolloj arsyeje dhe nga cilado gjykate apo juridiksion kompetent, një dispozitë/nen i tillë do të shfuqizohet apo nuk do të prodhojë efekte pa sjellë pasoja për dispozitat që mbeten. Nëse një dispozitë/nen i kësaj Kontrate që është thelbësor për përmbushjen e qëllimit të saj, rezulton i pavlefshëm apo i pazbatueshëm, për çfarëdolloj arsyeje dhe nga cilado gjykate apo juridiksion kompetent, Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues do të fillojnë menjëherë negociatat në mirëbesim për të ndrequr këtë pavlefshmëri.

27.2 Ndryshimet e Kontratës

Kjo Kontratë mund të ndryshohet, në përputhje me parashikimet e nenit 31, të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik/Privat”, të ndryshuar. Çdo ndryshim i kësaj kontrate, do të behet me marrëveshje të shkruar të të dy Palëve dhe e nënshkruar rregullisht prej tyre. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate apo Anekseve bashkëlidhur, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Kontrate.

27.3 Njoftimet

27.3.1 Çdo njoftim sipas apo në lidhje me këtë Kontratë do të jetë me shkrim, i nënshkruar nga Pala që e bën njoftimin apo përfaqësuesi i saj i autorizuar rregullisht dhe do të njoftohet përmes dërgimit personalisht apo dërgimit me postë rekomande, në adresën e deklaruar nga Pala në këtë Kontrate. Njoftimet për lehtësi mund të dërgohen me poste elektronike (*e-mail*). Njoftimi me e-mail për të qenë i vlefshëm duhet të shoqërohet me njoftim personalisht apo me postë rekomande.

27.3.2 Një njoftim do të konsiderohet si i marrë në mënyrë të vlefshme (përfshirë njoftimin për ndryshimin e adresës si më poshtë):

- (i) nëse është dërguar personalisht, konsiderohet i marrë të nesërmen e ditës së dorëzimit;
- (ii) nëse është dërguar me postë rekomande, konsiderohet i dorëzuar me marrjen e lajmërimit të dorëzimit;

Adresat për njoftime dhe komunikime sipas kësaj Kontrate janë:

Autoriteti Kontraktues:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Rruga “Abdi Toptani”, nr. 1,

Tiranë, Shqipëri

Koncesionari:

27.4 Konfidencialiteti

Të gjitha të dhënat dhe dokumentet (financiare, teknike apo të çdo lloji tjetër) të dhëna nga njëra Palë, Palës tjetër, përveç kur është detyrim ligjor apo rezultat i një kërkese apo urdhri nga organet kompetente shtetërore, nuk duhet t'i bëhen të njohura të tretëve, pa pëlqimin e Palës tjetër, me përjashtim të dhënies së informacioneve në kushte domosdoshmërie këshilltareve ligjorë/ auditeve të palës së interesuar. Ky parashikim do të jetë i vlefshëm deri në dy vjet pas përfundimit të Kontratës.

27.5 Kjo kontratë detyron Koncesionarin jo vetëm për sa është parashikuar në të, por edhe për të gjitha pasojat që rrjedhin nga zbatimi i Ligjeve.

27.6 Kjo Kontratë hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Palët, duke e pranuar me vullnet të lirë se janë ligjërisht të lidhura dhe duke gëzuar të gjitha tagrat ligjore, kanë nënshkruar këtë Kontratë në datën e treguar në të, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe të pavesuar.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Përfaqësuar nga

Në emër të Koncesionarit:

Përfaqësuar nga:

ANEKSET

ANEKS 1

DOKUMENTAT E PROCEDURËS KONKURRUESE PËR DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PORTIT TURISTIK “MARINA VLORE”

ANEKS 2

OFERTA E KONCESIONARIT (DOKUMENTAT E OFERTËS SË PARAQITUR NË DATËNNË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË)

ANEKS 3

PËRCAKTIMI HARTOGRAFIK - HARTAT

ANEKS 4

PLANIN E ZHVILLIMIT TË INVESTIMIT – GRAFIKU I PUNIMEVE

ANEKS 5

LISTA E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT – PREVENTIVI I PUNIMEVE

Shtojca 18

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS Punët

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është _____

1.2 Kontraktori është _____

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën 5% duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, kontraktorit sipas Shtojcës 19 "Formulari i sigurimit të kontratës"

Neni 3: Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor

3.1 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor: _____

3.2 Adresa/pika e kontaktit: _____

Neni 4: Kantieri

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i sakte i venddodhjes se objektit qe do te realizohet): _____

Neni 5 Data e Fillimit

5.1 Kjo kontratë: _____

Neni 6: Lloji i Kontratës

Shtojca 19

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[*Shtojce per tu paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Data _____]

Për : [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emer të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

Procedura e koncesionit/ ppp: [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (*objekti*)

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimit Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Duke gene se:

- (*emri i Ofertuesit Fitues*) është shpallur fitues ne Proceduren Konkurruese per Marrjen me Koncesion/PPP te _____, me vendndodhje ne _____, sipas shkreses se (emri i Autoritetit Kontraktor) (me poshte referuar si "Autoriteti Kontraktor"), Nr. ____ Prot, date ____ .2015, "Njoftimi i Fituesit" ; dhe
- Ofertuesi Fitues ka paraqitur prane nesh Draftin e Kontrates te lidhur ndermjet tij dhe Autoritetit Kontraktor, "Per marrjen me koncesion/ppp te _____ ; dhe
- ne Kontraten tuaj kerkohet leshimi i nje Sigurimi Kontrate ne vleren e specifikuar si me poshte, si garanci per permbushjen e detyrimeve te Koncesionarit te parashikuara ne Kontrate; dhe
- (*emri i Bankes/i shoqerise se sigurimit*) është dakord te leshoje kete garanci.

Deklarojme se:

- jemi garantuesit e kontrates se siperpermendur deri ne shumën totale prej 10 % (*shuma ne shifer dhe fjale*), shume e cila është e pagueshme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate; dhe
- marrim persiper te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej (*shuma e garancise*); dhe
- per marrjen e kesaj garancie, nuk është nevoja t'i drejtoheni me pare Koncesionarit\Partneritetit Publik Privat per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj; dhe
- asnje shtesë apo ndryshim i kushteve te Kontrates, per te cilen ju mund te bini dakord me Koncesionarin, nuk na cliron nga detyrimet e kesaj Garancie.

Kjo garanci është e vlefshme deri ne daten qe perfshin 30 dite nga data e leshimit te Certifikates së Perfundimit.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Shtojca 20

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I PUBLIKIMIT TE NJOFTIMIT TE KONTRATËS SE NËNSHKRUAR

Seksioni I Autoriteti Kontraktor

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Adresa në Internet _____

I.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion Qëndror	Institucion i Pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njesite e Qeverisjes Vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Seksioni II Objekti i Kontratës

II.1 Lloji i Kontratës

Punë	Shërbime
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1.Objekti i kontratës _____
2. Forma e Kontratës _____
3. Burimi i Financimit _____

II.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj ose ditë

ose

duke filluar nga // me përfundim në //

Seksioni III Procedura

III.1 Lloji i procedurës:

E hapur	E kufizuar	Me negociim me shpallje paraprake
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

III.2 Numri i ofertave të dorëzuara:
rregullta:

Numri i ofertave të

Seksioni IV Informacion mbi kontratën

IV.1 Numri i Kontratës: _____
//

Data e Kontratës

IV.2 Emri dhe adresa e kontraktorit

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Adresa e Internetit _____

IV.3 Vlera Totale

Vlera _____ (pa TVSH) Monedha _____

IV.4 Informacione shtesë (nëse ka)

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi //

Shtojca 21

**FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT
KONTRAKTOR**

Ankesë drejtuar : *Autoriteti Kontraktor*

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërorish).

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për koncesionin/ppp në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar (PK), Procedurë me Negociim me shpallje paraprake (PN),).

2. Autoriteti Kontraktor

Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

3. Vlera e Përlogaritur e Koncesionit/PPP

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/ shërbimeve që blihen.

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

3. Lista e Shtojcave

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë.

Mundësisht bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj**. Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave perkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për koncesionin/ ppp, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

4. Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktues

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejtpërdrejt autoritetit kontraktues. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.

1. Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (psh, me shkrim, nepermjet faksit, etj).

Po **Jo**

-
2. Autoriteti Kontraktues Pranë të Cilit është bërë Kundërshtimi

Emri i autoritetit kontraktues.

Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.

-
3. Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese

Çfarë mase korrigjuese kërkon?

-
4. Lista

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e procedures konkurruese, me të gjitha ndryshimet***

dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë. Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për konkurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: **Autoriteti perkates sipas ligjit nr. 125/2013 “Per koncensionet dhe partneritetin publik privat”**

Nr. Faks:

E-mail:

Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

Nr. Faks:

E-mail:

Nenshkrimi dhe Vula e Ankues

Shtojca 22

FORMULARI I PROKURËS

PROKURË

Sot më datë, muaji, viti

Perpara meje

Noterit/es

I/E nenshkuari/a z./zj. _____
ne cilesine e tij/saj _____

Shtetesia _____

Mbajtes i Pasaportes ose Dokumentit te Identifikimit nr. _____ Leshuar
nga _____

Me date _____

Banues ne _____

Emeroj z./zj. _____ ne cilesine e tij/saj si _____, per te:

- (a) nenshkuar ose vulosur dhe per te dorezuar tek autoritetet kompetente te gjithë dokumentet e renditura ne Pasqyrën 1 bashkelidhur;
- (b) dorezuar dhe marre ne dorezim cdo lloj dokumenti apo instrumenti ne lidhje me dokumentet e renditura në Pasqyrën 1 bashkelidhur; dhe
- (c) Te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme ose shtese ne lidhje me ceshtjet e percaktuara ne kete dokument, perfshire edhe nenshkrimin dhe zbatimin e cdo akti, i cili nevojitet per te zbatuar per te plotesuar dokumentet e listuar ne Pasqyrën 1, ose qe keto dokumente te sjellin pasoja.

Dhe eshte i/e autorizuar te emeroje persona te tjere per te ushtruar te gjitha ose nje pjese te tagrave te percaktuara ne kete Prokure.